



# BULETIN MUJOR

I SHOQATËS SË KONTABILISTËVE DHE KONTABILISTËVE TË  
AUTORIZUAR TË MVP SHKUP

Viti II, Nr. 2

Korrik,2022

**Pasqyrë e të dhënave individuale për  
muajin korrik të vitit 2022 për  
sektorin privat, buxhetor dhe sektorin publik**



## LIGJ I KRYERJES SË PUNËVE TË KONTABILITETIT

Botues: SHKKAMV

Adresa: rr. Kazanxhiska nr.35-3/27 Shkup Çair

e-buletin

[www.shkkamvp.mk](http://www.shkkamvp.mk); [shkkamvp@gmail.com](mailto:shkkamvp@gmail.com)

**Përmbajtja:**

- 1) LIGJ I KRYERJES SË PUNËVE TË KONTABILITETIT**
- 2) Pasqyrë e të dhënave individuale për muajin korrik të vitit 2022 për sektorin privat, buxhetor dhe sektorin publik**

**1. LIGJ I KRYERJES SË PUNËVE TË KONTABILITETIT****I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME****Neni 1**

Me këtë ligj rregullohen kushtet e kryerjes së punëve të kontabilitetit, subjektet që kryejnë punë të kontabilitetit, kushtet për marrjen e statusit kontabilist dhe kontabilist i autorizuar, organizimi dhe puna e Institutit të kontabilistëve dhe të kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë, themelimi dhe kompetencat e Këshillit për avancimin dhe mbikëqyrjen mbi profesionin e kontabilitetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me kryerjen e punëve të kontabilitetit. Definicione

**Neni 2**

Nocionet e caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin vijues:

1. "Punë të kontabilitetit" janë identifikimi, sortimi dhe përpunimi i të dhënave në bazë të dokumenteve të kontabilitetit, përgatitja dhe mbajtja e librave tregtare/afariste për transaksione financiare të obliguesit për udhëheqjen e kontabilitetit, analiza e tyre, evidentimi dhe përpilimi i llogarisë vjetore dhe/ose raporteve financiare në përputhje me ligjin;
2. "Këshilli për avancimin dhe mbikëqyrjen e profesionit të kontabilitetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut" është organ i pavarur rregullator për avancimin dhe mbikëqyrjen e profesionit të kontabilitetit dhe mbikëqyrjen mbi punën e Institutit të kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
3. "Institut i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut" është shoqëria profesionale e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar e themeluar në përputhje me këtë ligj;
4. "Obligues për udhëheqjen e kontabilitetit" është peroni fizik ose juridik i cili ka obligim që të mbajë libra tregtare/afariste dhe të përpilojë llogari vjetore dhe/ose raporte financiare në përputhje me ligjin;
5. "Ushtrues i punëve të kontabilitetit" është personi i punësuar që mund të ketë statusin e kontabilistit dhe/ose kontabilistit të autorizuar;
6. "Praktikant i kontabilitetit" është personi fizik, i cili nuk ka dhënë provimin për marrjen e statusit të kontabilistit ose kontabilistit të autorizuar, pa të drejtën e \* Me këtë ligj bëhet harmonizimi i Regullativës (BE) nr.1092/2010 të Parlamentit dhe të Këshillit Europian të datës 24 nëntor të vitit 2010 për mbikëqyrje makroprudente të sistemit financiar të Bashkimit Europian dhe formimi i Këshillit Europian për rrezik sistemor (CELEX nr. 32010R1092). 2022 nënshkrimi të llogarive vjetore dhe/ose raporteve financiare, i cili është i punësuar ose ka statusin e praktikantit në përputhje me ligjin, pa përvojë pune prej dy viteve në kryerjen e punëve të kontabilitetit nën mentorimin e kontabilistit dhe/ose kontabilistit të autorizuar;
7. "Kontabilist" është personi fizik, i cili ka së paku dy vjet përvojë pune në kryerjen e punëve të kontabilitetit nën mentorimin e kontabilistit dhe/ose kontabilistit të autorizuar dhe ka dhënë provimin për marrjen e statusit të kontabilistit, përkatësisht ka certifikatë për kontabilist nga Instituti i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe që është i regjistruar në Regjistrin e kontabilistëve në përputhje me këtë ligj;
8. "Kontabilist i autorizuar" është personi fizik i cili ka së paku dy vjet përvojë pune në kryerjen e punëve të kontabilitetit nën mentorimin e kontabilistit dhe/ose kontabilistit të autorizuar dhe që ka dhënë provimin për marrjen e statusit të kontabilistit të autorizuar, përkatësisht ka certifikatë për kontabilist të autorizuar nga Instituti i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe që është i regjistruar në Regjistrin e kontabilistëve të autorizuar në përputhje me këtë ligj;

9. "Provimi për marrjen e statusit të kontabilistit dhe/ose kontabilistit të autorizuar" është provim i organizuar dhe realizuar nga Instituti i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
10. "Tregtar individ – kontabilist" është personi fizik i cili është i regjistruar për kryerjen e punëve kontabiliste në përputhje me ligj, me licencë për punë të lëshuar nga Instituti i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i regjistruar në Regjistrin e tregtarëve individë - kontabilistë në përputhje me këtë ligj;
11. "Tregtar individ - kontabilist i autorizuar" është personi fizik i cili është i regjistruar për kryerjen e punëve të kontabilitetit në përputhje me ligj, me licencë për punë të lëshuar nga Instituti i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i regjistruar në Regjistrin e tregtarëve individë – kontabilistë të autorizuar në përputhje me këtë ligj;
12. "Shoqëria për kryerjen e punëve të kontabilitetit" është shoqëri tregtare që është e regjistruar për kryerjen e punëve të kontabilitetit në përputhje me ligj, me licencë për punë të lëshuar nga Instituti i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e regjistruar në Regjistrin e shoqërisë për kryerjen e punëve të kontabilitetit në përputhje me këtë ligj;
13. "Regjistër i praktikantëve të kontabilitetit" është libri për evidencë në të cilin janë përfshirë të dhënat për praktikantët e kontabilitetit e cila mbahet në Institutin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
14. "Regjistër i kontabilistëve" është libri për evidencë në të cilin janë përfshirë të dhënat për kontabilistë i cili mbahet në Institutin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
15. "Regjistër i kontabilistëve të autorizuar" është libri për evidencë në të cilin janë përfshirë të dhënat për tregtarët individë - kontabilistë të autorizuar i cili mbahet në Institutin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
16. "Regjistër i tregtarëve individë – kontabilistë" është libri për evidencë në të cilin janë përfshirë të dhënat për tregtarët individë - kontabilistë i cili mbahet në Institutin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
17. "Regjistër i tregtarëve individë – kontabilistë të autorizuar" është libri për evidencë në të cilin janë përfshirë të dhënat për tregtarët individë – kontabilistë të autorizuar i cili mbahet në Institutin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
18. "Regjistër i shoqërisë për kryerjen e punëve të kontabilitetit" është libri për evidencë në të cilin janë përfshirë të dhënat për shoqërinë për kryerjen e punëve të kontabilitetit i cili mbahet në Institutin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
19. "Regjistër i personave juridikë që kryejnë trajnime për përsosje të vazhdueshme profesionale" është libri për evidencë në të cilin janë përfshirë të dhënat për personat juridikë që kryejnë trajnime për përsosje të vazhdueshme profesionale, i cili mbahet në Institutin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
20. "Licencë për tregtar individ - kontabilist" është licencë për punë të kontabilistit të lëshuar nga Instituti i kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me këtë ligj;
21. "Licencë për tregtar individ – kontabilist të autorizuar" është licencë për punë të kontabilistit të autorizuar e lëshuar nga Instituti i kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me këtë ligj;
22. "Licencë për shoqërinë për kryerjen e punëve të kontabilitetit" është licencë për punën e shoqërisë tregtare e lëshuar nga Instituti i kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me këtë ligj;

23. "Cerifikatë për kontabilist përkatësisht kontabilist të autorizuar" është dokumenti i lëshuar nga Instituti i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut për personat që kanë dhënë provimin për marrjen e statusit kontabilist, përkatësisht kontabilist i autorizuar.
24. "Shkelje disiplinore" është mosveprimi ose veprimi në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, ligjet që rregullojnë udhëheqjen e kontabilitetit, Kodin e etikës për kontabilistët profesionistë të Federatës ndërkombëtare të kontabilistëve (IFAC) dhe aktet e Institutit të kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
25. "Përsosje e vazhdueshme profesionale" është përsosja e përhershme profesionale me qëllim të përsosjes së njohurive dhe aftësive teorike dhe praktike për kryerje më efikase dhe profesionale të punëve të kontabilitetit;
26. "Vendet anëtare të Zonës ekonomike europiane" janë vendet anëtare të Bashkimit Europian dhe vendet e Norvegjisë, Islandës dhe Lihtenshtajnit;
27. "SNRF" janë standarde ndërkombëtare për raportim financiar të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
28. "SNRF për NVM" është standard për raportim financiar për subjektet e vogla dhe të mesme të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
29. "IFAC" është Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve.

**II. KËSHILLI PËR AVANCIMIN DHE MBIKËQYRJEN MBI PROFESIONIN E KONTABILITETIT I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT** Statusi i Këshillit për Avancimin dhe mbikëqyrjen mbi profesionin e kontabilitetit i Republikës së Maqedonisë së Veriut

**Neni 3**

- (1) Për shkak të avancimit dhe mbikëqyrjes së profesionit të kontabilitetit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut themelon Këshillin për avancimin 1 август 2022 Бр. 173 - Стр. 35 dhe mbikëqyrjen e profesionit të kontabilitetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut si organ i pavarur rregullator, me autorizime publike të përcaktuara me këtë ligj (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli).
- (2) Këshilli e fiton cilësinë e personit juridik me regjistrim në Regjistrin e personave të tjerë juridikë që mbahet në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Regjistri Qendror).
- (3) Selia e Këshillit është në Shkup.
- (4) Këshilli për punën e tij përgjigjet para Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Statuti i Këshillit

**Neni 4**

- (1) Këshilli miraton statut me të cilin rregullohet organizimi i brendshëm, udhëheqja, mënyra e miratimit të akteve dhe kushtet për punësimin e të punësuarve në shërbimin profesional dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e Këshillit.

(2) Për statutin sipas paragrafit (1) të këtij neni, pëlqim jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Statuti sipas paragrafit (1) të këtij neni do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

#### Neni 5 (Puna e Këshillit )

(1) Këshilli kryen këto punë: 1) miraton rregulloren lidhur me punën e tij, programin vjetor të punës, planin vjetor financiar dhe raportin vjetor lidhur me punën e Këshillit;

2) inicon kontrollin e tregtarëve individë -kontabilistë, tregtarëve individë - kontabilistë të autorizuar dhe shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilitetit në Institutin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

3) jep pëlqim për statutin dhe aktet e tjera të Institutit të kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut, monitoron aplikimin e tyre dhe i thekson Institutit të kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut sa i përket nevojës për ndryshimin dhe plotësimin e tyre;

4) monitoron zbatimin e programit vjetor dhe trevjeçar të kontrollit nëpërmjet raporteve nga kontrolli i kryer i Institutit të kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

5) monitoron zbatimin e programeve vjetore për dhënien e provimit dhe për përsosjen e vazhdueshme profesionale të Institutit të kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

6) monitoron procedurën për njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë vendit të cilën e zbaton Instituti i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut; 7) monitoron dhe kontrollon kryerjen e kontrollit të cilësisë nga Instituti dhe jep rekomandime për përmirësimin e zbatimit të kontrollit të cilësisë dhe nëse është e nevojshme merr pjesë në procedurat e kontrollimit të shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilitetit dhe tregtarit individ - kontabilist, përkatësisht kontabilistit të autorizuar.

8) mbikëqyr punën e Institutit të kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe shqipton masa për parregullsitë dhe/ose paligjshmëritë e konstatuara sipas nenit 49 paragrafi (5) të këtij ligji;

9) jep udhëzime ndaj Institutit të kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut për çështjet për të cilat është kompetent në përputhje me këtë ligj;

10) monitoron zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të miratuara në bazë të këtij ligji dhe i jep mendim ministrit të Financave për nevojën e përgatitjes së ndryshimeve dhe plotësimet e tyre;

11) miraton plan vjetor për punësimin e personave në shërbimin profesional të Këshillit dhe

12) kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe me statut. (2) Pëlqim për aktet sipas paragrafit (1) pika 1) të këtij neni jep Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (3) Pas marrjes së pëlqimit nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, aktet sipas paragrafit (1) pika 1) të këtij neni publikohen në ueb-faqen elektronike të Këshillit.

#### Neni 6 Përbërja e Këshillit

- (1) Këshillin e përbëjnë pesë anëtarë, njëri prej të cilëve është kryetari, edhe atë: 1) dy anëtarë propozohen nga ministri i Financave, 2) një anëtar e propozon Akademia Maqedonase e Shkencave dhe e Arteve nga radhët e profesorëve të rregullt të Fakulteteve ekonomike në shtet, 3) një anëtar propozohet në mënyrë të përbashkët nga Oda Ekonomike e Maqedonisë së Veriut, Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore dhe 4) një anëtar propozohet nga Kuvendi i Institutit.
- (2) Anëtari i propozuar sipas paragrafit 1 pika 3) të këtij neni nuk duhet të jetë anëtar i organeve të Institutit dhe të mos ketë kryer punë të kontabilitetit gjatë tri viteve të fundit deri në ditën e propozimit të tij si anëtar në Këshill.
- (3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut emëron dhe shkarkon kryetarin dhe anëtarët e Këshillit.
- (4) Gjatë emërimit të kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit sipas paragrafit (2) të këtij neni, respektohet parimi i përfaqësimit adekuat e pjesëtarëve të komuniteteve.
- (5) Kryetari udhëheq punën e Këshillit dhe e përfaqëson atë në marrëdhëniet me personat e tretë.
- (6) Mandati i kryetarit dhe i anëtarëve të Këshillit është pesë vite, pa mundësinë e ripërzgjedhjes .

#### Neni 7 Kushtet për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit

- (1) Si kryetar dhe anëtar të Këshillit mund të propozohet personi që i përmbush këto kushte: - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, - të ketë të përfunduar arsimin e lartë në sferën e ekonomisë ose juridikut, - të mos jetë i punësuar në Institutin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të mos jetë anëtar i asnjë organi ekzekutiv të tij, - të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në sferën e kontabilitetit ose financave, - të mos jetë i dënuar në a për vepër penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor, ekonomisë dhe detyrës zyrtare dhe - të mos jetë i jetë shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- (2) Për kryetar dhe anëtar të Këshillit nuk mund të propozohet personi: - që është zyrtar i cili udhëheq organin shtetëror ose organin e administratës shtetërore dhe - që është bartës i funksionit në organet e partisë politike dhe/ose anëtar i organit mbikëqyrës, organit të menaxhimit ose ndonjë organi tjetër të personit juridik të sektorit publik të themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Стр. 36 - Бр. 173 1 август 2022
- (3) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit punën e tyre e kryejnë në atë mënyrë që nuk do ta rrezikojnë pavarësinë dhe autonominë e Këshillit.
- (4) Këshilli është i pavarur dhe autonom në kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj.

#### Neni 8 Të drejtat e kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit

- (1) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit kanë të drejtë të kompensimit mujor të siguruar nga mjetet e Këshillit të përcaktuara me planin vjetor financiar, në vlerë deri në 50% të pagës mesatare

mujore neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut në muajin e fundit të vitit paraprak e publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikave.

(2) Çështjet administrativo-teknike lidhur me punën e Këshillit i kryen shërbimi profesional i Këshillit i përbërë së paku nga tre të punësuar. Puna e shërbimit profesional lidhur me Këshillin organizohet dhe koordinohet nga njëri prej të punësuarit, i cili emërohet nga Këshilli me propozim të kryetarit.

(3) Mjetet për pagën e të punësuarve në shërbimin profesional të Këshillit, si dhe mjetet për kompensimin mujor të kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit përcaktohen në planin vjetor financiar të Këshillit.

#### Neni 9 Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë ose njoftim të pranuar nga institucioni që i ka emëruar, para përfundimit të mandatit për të cilin janë emëruar mund ta shkarkojë kryetarin dhe anëtarët e Këshillit nëse: - kërkojnë dhe japin dorëheqje tek institucioni që i ka emëruar; - nuk vijojnë me përmbushjen e kushteve sipas nenit 7 të këtij ligji; - shkelin detyrimin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidenciale dhe - mungojnë në mënyrë të pajustificueshme në tre mbledhje të Këshillit radhazi ose mungojnë në mënyrë të pajustificueshme në pesë mbledhjet gjatë një viti.

(2) Funkcioni i anëtarit të Këshillit përfundon në rast vdekjeje ose humbjeje të aftësisë afariste.

(3) Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit në përputhje me këtë ligj, në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të mandatit, institucioni që e ka propozuar në vend të tij në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut propozon një person tjetër deri në përfundimin e mandatit të kryetarit, përkatësisht anëtarit të cilit i përfundon përmbushja e detyrës.

(4) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të propozimit sipas paragrafit (3) të këtij neni, do të emërojë kryetar të ri, përkatësisht anëtar të ri të Këshillit.

#### Neni 10 Vendimmarrja e Këshillit

(1) Këshilli vendos në mbledhje.

(2) Këshilli mund të miratojë vendime nga kompetenca e tij nëse gjatë mbledhjes janë të pranishëm shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

(3) Kryetari dhe anëtarët e Këshillit nuk mund të abstenojnë gjatë votimit.

(4) Vendimet e Këshillit konsiderohen të miratuara nëse janë votuar me shumicën e anëtarëve të pranishëm gjatë mbledhjes.

#### Neni 11 Mjetet lidhur me punën e Këshillit

Puna e Këshillit financohet nga: - 3% nga të hyrat e përgjithshme të realizuara të Institutit të kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut; - Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe - të hyrat e tjera të realizuara gjatë funksionimit të Këshillit.



**Neni 12**

- (1) Të punësuarit në shërbimin profesional të Këshillit, që kryejnë punë të natyrës administrative, kanë statusin e nëpunësve administrativë.
- (2) Për çështjet që i referohen punësimit të të punësuarve sipas paragrafit (1) të këtij neni, të cilat nuk janë të rregulluara me këtë ligj dhe me marrëveshje kolektive, zbatohen dispozitat e Ligjit të Nëpunësve Administrativë dhe me rregulloret e përgjithshme për marrëdhëniet e punës.
- (3) Të punësuarit në shërbimin profesional të Këshillit që kryejnë punë ndihmëse – teknike, kanë statusin e personelit ndihmës - teknik.
- (4) Për personelin ndihmës - teknik në shërbimin profesional të Këshillit zbatohen rregulloret e përgjithshme për marrëdhëniet e punës.

**Neni 13**

Mënyra e përcaktimit të pagës themelore dhe shtesave në pagë lidhur me të punësuarit në shërbimin profesional të Këshillit, rregullohet me marrëveshje kolektive, kurse vlera e pikës së pagës themelore përcaktohet nga Këshilli me pëlqim paraprak të Qeverisë së Republikës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

**III. INSTITUTI I KONTABILISTËVE DHE I KONTABILISTËVE TË AUTORIZUAR I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT****Neni 14**

- (1) Kontabilistët dhe kontabilistët e autorizuar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut organizohen në Institutin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Instituti).
- (2) Instituti ka cilësinë e personit juridik me autorizime publike. Statusin e personit juridik e fiton duke u regjistruar në Regjistrin e personave të tjerë juridikë i cili mbahet në Regjistrin Qendror.
- (3) Selia e Institutit është në Shkup.
- (4) Instituti formon filiale sipas parimit territorial për një ose më shumë njësi të vetëqeverisjes lokale. Filialet nuk kanë status të personit juridik.
- (5) Puna rrjedhëse e Institutit kryhet nga shërbimi profesional. Shërbimi profesional udhëhiqet nga sekretari i përzgjedhur me shpallje publike.
- (6) Të punësuarit në shërbimin profesional janë të angazhuar në mënyrë profesionale, me orar të plotë të punës dhe kanë të drejtë të pagës dhe kompensimeve sipas rregulloreve të përgjithshme të marrëdhënieve të punës.
- (7) Instituti ka statut. Statuti i Institutit rregullon në veçanti organizimin, udhëheqjen, punën, financimin dhe përfaqësimin e anëtarëve të Institutit në të gjitha organet e tij.

**Neni 15**

- (1) Organet e Institutit janë Kuvendi i Institutit, Këshilli mbikëqyrës, Këshilli drejtues dhe kryetari i Institutit.
- (2) Instituti për kryerjen e punëve nga fushëveprimi i tij themelon: 1) Komisioni disiplinor; 2) Komisioni i standardeve të raportimit financiar dhe 3) Komisioni për arsim, trajnim dhe publikime;
- (3) Instituti mund të formojë komisione të tjera të përhershme dhe të përkohshme të përcaktuara me Statutin e Institutit. 1 абрь 2022 Ёр. 173 - Стр. 37
- (4) Anëtarët e organeve dhe anëtarët e komisioneve përzgjidhen nga radhët e anëtarëve të Institutit, që nuk janë të punësuar në Institutin, me të drejtë rizgjedhjeje, por jo më shumë se dy mandate radhazi.
- (5) Në organet dhe komisionet e Institutit nuk mund të zgjidhet më shumë se një person i cili është i punësuar ose është themelues i të njëjtit tregtar individual-kontabilist, tregtar individual kontabilist i autorizuar dhe shoqëri për kryerjen e punëve të kontabilitetit.
- (6) Në Komisionin e standardeve të raportimit financiar, përveç anëtarëve të tjerë, anëtar i detyrueshëm është edhe një profesor universitar në sferën e kontabilitetit dhe revizionit, ndërsa në Komisionin për arsim, trajnim dhe publikime, përveç anëtarëve të tjerë, anëtar i detyrueshëm është edhe një profesor universitar në sferën e edukimit, metodologjisë dhe didaktikës në mësimdhënie.
- (7) Mënyra e punës, përbërja dhe mandati i komisioneve sipas paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni përcaktohen me Statutin e Institutit.

#### Neni 16

Instituti në veçanti kryen këto aktivitete:

- 1) mban regjistër të praktikantëve të kontabilitetit, regjistër të kontabilistëve, regjistër të kontabilistëve të autorizuar, regjistër të tregtarëve individë – kontabilistë, regjistër të tregtarëve individë - kontabilistë të autorizuar, regjistër të shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilitetit dhe regjistër të personave juridikë që kryejnë trajnime për përsosje të vazhdueshme profesionale;
- 2) kryen shkëmbim elektronik të të dhënave nga regjistri i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar me Regjistrin Qendror me qëllim të nënshkrimit të llogarisë vjetore dhe të raporteve financiare.
- 3) kryen shkëmbim elektronik të të dhënave nga regjistri i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar me Drejtorinë e të Ardhurave Publike për qëllime të parashtrimit të fletëparaqitjeve tatimore.
- 4) kontrollon punën e ushtruesve të punëve të kontabilitetit, tregtarëve individë - kontabilistë, tregtarëve individë - kontabilistë të autorizuar dhe shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilitetit;
- 5) organizon dhe zhvillon provimin për marrjen e statusit të kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar;
- 6) lëshon certifikatë për kontabilist dhe certifikatë për kontabilist të autorizuar;
- 7) lëshon dhe heq licencat për punë të tregtarëve individë - kontabilistë, tregtarëve individë – kontabilistë të autorizuar dhe shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilitetit;

- 8) vendos ndaj kërkesave për miratimin e kualifikimit për kontabilist dhe kontabilist të autorizuar të fituar jashtë vendit;
- 9) organizon dhe zhvillon provimin për miratimin e kualifikimit për kontabilist dhe kontabilist të autorizuar të fituar jashtë vendit;
- 10) jep leje për personat juridikë që do të zhvillojnë trajnime për përsosje të vazhdueshme profesionale nën mbikëqyrjen e Institutit;
- 11) organizon simpoziume ndërkombëtare dhe vendore në sferën e kontabilitetit;
- 12) monitoron zbatimin e Kodit të Etikës për kontabilistë profesionistë të IFAC;
- 13) perkthen SNRF dhe SNRF për SVM;
- 14) bashkëpunon me organet e tjera profesionale në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe jashtë vendit dhe
- 15) kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj.

#### Neni 17

- (1) Kuvendi i Institutit përbëhet nga të gjithë kontabilistët dhe kontabilistët e autorizuar të përfaqësuar nga përfaqësues të përzgjedhur nga filialet e Institutit.
- (2) Kuvendi i Institutit përbëhet nga gjithsej 50 përfaqësues të përzgjedhur nga filialet e Institutit.
- (3) Mandati i secilit përfaqësues të përzgjedhur në Kuvendin e Institutit zgjat katër vjet, me mundësi të ripërzgjedhjes.
- (4) Përfaqësuesit në Kuvend përzgjidhen nga anëtarët e filialeve të Institutit.
- (5) Çdo filial ka të drejtë të përzgjedhë anëtarë të Kuvendit, në përputhje me numrin e kontabilistëve të regjistruar dhe kontabilistëve të autorizuar në filialin në raport me numrin e përgjithshëm të kontabilistëve të regjistruar dhe kontabilistëve të autorizuar të Institutit. Procedura e përzgjedhjes së përfaqësuesve nga filialet në Kuvend rregullohet në mënyrë të detajuar me Statutin e Institutit.
- (6) Shërbimi profesional i Institutit së paku një herë në vit dhe më së voni deri në datë 31 maj të vitit rrjedhës në faqen e internetit të Institutit publikon listat e përditësuara dhe të konsoliduara të kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar sipas filialeve.
- (7) Përfaqësuesit e filialeve që janë anëtarë të Kuvendit të Institutit, mund të revokohen me vendim të miratuar me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm në mbledhjen e filialit.
- (8) Mandatin e ndërprerë të përfaqësuesit në Kuvend e vazhdon anëtari i përzgjedhur i filialit dhe ky mandat zgjat deri në përfundimin ekzistues të të tij.
- (9) Anëtarët e filialeve vendosin në mbledhjet që mbahen së paku një herë në vit, jo më vonë se data 30 shtator të vitit rrjedhës, të cilat thirren me iniciativë të kryetarit të Institutit ose me iniciativë të parashtruar me shkrim në shërbimet e Institutit, të nënshkruar me më shumë se 20% nga anëtarët e filialit që janë të regjistruar në regjistrat e Institutit në momentin e paraqitjes së iniciativës.
- (10) Mbajtjen e mbledhjeve të filialeve e përcakton parashtruesi i iniciativës sipas paragrafit (9) të këtij neni dhe ato publikohen në ueb faqen e internetit të Institutit. Që të mund të merren vendime në mbledhjet e filialeve, kërkohet prania e të paktën 20% të anëtarëve të filialit që

janë të regjistruar në regjistrat e Institutit. Nëse në dy mbledhje radhazi të një filiali nuk sigurohet pjesëmarrje minimale prej të paktën 20% të anëtarëve të filialit të regjistruar në regjistrat e Institutit, vendimet e mbledhjes së tretë radhazi merren me shumicë të thjeshtë të të pranishmëve.

(11) Filiali nuk mund të organizohet me më pak se 200 anëtarë. Kontabilist ose kontabilist i autorizuar mund të regjistrohet vetëm në një filial, sipas vendbanimit ekzistues.

(12) Kuvendi i Institutit: 1) përzgjedh dhe revokon kryetarin dhe anëtarët e Këshillit drejtues të Institutit, me shumicë të thjeshtë të numrit të pranishëm të anëtarëve në mbledhje; 2) përzgjedh dhe revokon kryetarin dhe anëtarët e Këshillit mbikëqyrës të Institutit, me shumicë të thjeshtë të numrit të pranishëm të anëtarëve në mbledhje; 3) përzgjedh dhe revokon kryetarin dhe anëtarët e komisioneve të Institutit, me shumicë të thjeshtë të numrit të pranishëm të anëtarëve në mbledhje; 4) miraton Statutin e Institutit; 5) shqyrton dhe miraton të gjitha aktet me propozim të komisioneve të Institutit; 6) përcakton vlerën e kompensimit për anëtarësim; 7) përcakton vlerën e kompensimeve për dhënien e licencave të punës; 8) miraton programin për dhënien e provimit për marrjen e statusit kontabilist dhe kontabilist të autorizuar; 9) miraton programin për miratimin e kualifikimit për kontabilist dhe kontabilist të autorizuar të fituar jashtë vendit; 10) përcakton vlerën e kompensimit për dhënien e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit dhe kontabilistit të autorizuar; 11) përcakton vlerën e kompensimit për lëshimin e certifikatës për kontabilist dhe kontabilist të autorizuar; 12) përcakton vlerën e kompensimit për dhënien e provimit për njohjen e kualifikimit profesional të fituar jashtë vendit; 13) aprovon punën e Këshillit mbikëqyrës në mbledhje vjetore; 14) përcakton mënyrën e mbajtjes dhe dhënies së provimit për marrjen e statusit të kontabilistit dhe kontabilistit të autorizuar; Сrp. 38 - Бp. 173 1 аврyст 2022 15) miraton programin vjetor për punë dhe zhvillim dhe planin vjetor financiar të Institutit; 16) zgjedh shoqërinë e revizionit; 17) miraton llogarinë vjetore, raportin vjetor të punës dhe raportin e revizorit për llogarinë vjetore të Institutit; 18) e përcakton lartësinë e kompensimit për përsosje të vazhdueshme profesionale. 19) vendos për formimin dhe ndërprerjen e filialeve të Institutit; 20) vendos për vlerën e pagave për kryetarin e Institutit, sekretarin dhe të punësuarit në shërbimin profesional të Institutit, si dhe për të gjitha kompensimet e anëtarëve të organeve të Institutit dhe 21) vendos për çështje të tjera në pajtim me këtë ligj.

(13) Kompensimin për anëtarësim sipas paragrafit (12) pika 6) të këtij neni, Instituti e cakton në bazë të shpenzimeve të kryera reale nga Instituti.

(14) Instituti i përcakton kompensimet sipas paragrafit (12) pikat 7), 10), 11) dhe 12) të këtij neni me çmimore në bazë të shpenzimeve të kryera reale për shtypjen dhe dhënien e licencave të punës, dhënien e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit ose kontabilistit të autorizuar, për lëshimin e certifikatës për kontabilist ose kontabilist të autorizuar dhe për marrjen e provimit për kualifikim profesional të fituar jashtë vendit.

(15) Këshilli jep pëlqime të akteve sipas paragrafit (12) pikat 4), 6), 8), 9), 15), 17) dhe 18) të këtij neni dhe të çmimores sipas paragrafit (14) të këtij neni.

(16) Aktet e Kuvendit publikohen në ueb-faqen e internetit të Institutit në afat prej 48 orëve nga dita e aprovimit, përkatësisht miratimit të tyre.

(17) Puna e Kuvendit rregullohet me Rregulloren e punës.

Neni 18

- (1) Kuvendi i Institutit mblidhet së paku dy herë në vit.
- (2) Mbledhja e rregullt vjetore e Kuvendit mbahet më së voni deri në datë 15 prill. Mbledhjet e Kuvendit mbahen nëse janë të pranishëm së paku gjysma nga numri i përgjithshëm i përfaqësuesve të përzgjedhur nga filialet e Institutit. Kuvendi vendimet i miraton me shumicë të thjeshtë nga numri i anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
- (3) Në rast se anëtarët e Kuvendit nuk mund të marrin pjesë fizikisht në mbledhje, për shkak të rrezikut shëndetësor ose për arsye dhe nevoja urgjente, mbledhjet e Kuvendit mund të mbahen online nëpërmjet sistemit elektronik të Institutit. Mbledhjet e Kuvendit online mbahen nëse janë të pranishëm së paku gjysma e përfaqësuesve të përzgjedhur nga filialet e Institutit.
- (4) Me mbledhjen e Kuvendit kryeson një anëtar i Kuvendit i përzgjedhur nga anëtarët e pranishëm të Kuvendit në mbledhje, me mandat deri në përzgjedhjen e kryesuesit në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit. Kryesuesi i Kuvendit përcakton rendin e punës dhe mban rendin e mbledhjes.
- (5) Për kryesues të Kuvendit nuk mund të përzgjidhet kryetar i Institutit, anëtar i Këshillit drejtues, i Këshillit mbikëqyrës ose i Komisionit të Institutit.
- (6) Në rast të pamundësisë së kryesuesit për të marrë pjesë dhe për të udhëhequr mbledhjen në Kuvend, deri në përzgjedhjen e kryesuesit të ri, anëtari më i vjetër i pranishëm në mbledhje kryeson dhe udhëheq me mbledhjen.
- (7) Mbledhjet e Kuvendit i thërret kryetari i Institutit në bazë të vendimit të Këshillit drejtues ose me kërkesë me shkrim të parashtruar te kryetari i Institutit, te kryetari i Këshillit mbikëqyrës i Institutit ose te kryesuesi i mbledhjes së mbajtur të fundit të Kuvendit dhe e nënshkruar nga së paku gjysma e përfaqësuesve të përzgjedhur nga filialet e Kuvendit.
- (8) Kryetari i Institutit do të thërrasë mbledhjen e Kuvendit në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të vendimit të Këshillit drejtues, përkatësisht nga kërkesa e parashtruar me shkrim e përfaqësuesve të përzgjedhur nga filialet e Kuvendit.
- (9) Nëse kryetari i Institutit nuk thërret mbledhjen e Kuvendit në afatin e përcaktuar me paragrafin (8) të këtij neni, mbledhjen e thërret kryetari i Këshillit mbikëqyrës në afat prej shtatë ditësh pas përfundimit të afatit sipas paragrafit (8) të këtij neni.
- (10) Nëse kryetari i Këshillit mbikëqyrës nuk thërret mbledhjen e Kuvendit të Institutit në afatin sipas paragrafit (9) të këtij neni, mbledhjen do ta thërrasë kryesuesi i mbledhjes së mbajtur të fundit të Kuvendit, në afat prej shtatë ditësh pas përfundimit të afatit sipas paragrafit (9) të këtij neni, ndërkaq do ta udhëheqë kryesia e punës e përbërë prej tre anëtarëve të përzgjedhur nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e Kuvendit.
- (11) Nëse kryesuesi i Kuvendit të fundit të mbajtur të Institutit nuk e thërret mbledhjen e Kuvendit në afatin sipas paragrafit (10) të këtij neni, mbledhjen do ta thërrasë Këshilli në afat prej shtatë ditësh dhe me të do të udhëheqë kryesia e punës prej tre anëtarëve të përzgjedhur nga anëtarët e pranishëm në Kuvendit.
- (12) Anëtarët e Kuvendit për çdo mbledhje të mbajtur kanë të drejtë në kompensim financiar i cili nuk duhet ta tejkalojë vlerën e 20% nga paga mesatare mujore neto për të punësuar në muajin dhjetor të vitit paraprak, të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikave, si dhe të drejtën për kompensim të shpenzimeve për rrugë.

## Neni 19

- (1) Këshillin mbikëqyrës e përbëjnë kryetari dhe katër anëtarë me mandat prej katër viteve pa të drejtë të ripërzgjedhjes.
- (2) Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës nuk mund të jenë anëtarë të organi ose komisioni tjetër të Institutit.
- (3) Mbledhjet e Këshillit mbikëqyrës thirren dhe udhëhiqen nga kryetari i Këshillit mbikëqyrës, ku nevojitet që të jenë të pranishëm shumica e numrit të përgjithshëm të Këshillit mbikëqyrës.
- (4) Nëse kryetari i Këshillit mbikëqyrës për arsye të ndrsyshme nuk mund ta kryejë funksionin ose mungon, mbledhjet e Këshillit mbikëqyrës thirren dhe udhëhiqen nga anëtari i Këshillit mbikëqyrës i përzgjedhur me shumicë votash nga të gjitha antarët e Këshillit mbikëqyrës.
- (5) Këshilli mbikëqyrës vendimet i miraton me votim publik, me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm në mbledhje.
- (6) Këshilli mbikëqyrës i Institutit: 1) kryen kontrole periodike lidhur me punën materiale dhe financiare të Institutit; 2) shqyrton planin vjetor për punë dhe zhvillim dhe planin vjetor financiar të Institutit dhe jep mendime lidhur me të te Kuvendi i Institutit; 3) shqyrton llogarinë vjetor dhe raportin vjetor për punën e Institutit dhe jep mendime lidhur me të deri të Kuvendi i Institutit; 4) te Kuvendi i Institutit në kohë inicon procedurë për përzgjedhjen e personit juridik për përpilimin e raportit të revizorit lidhur me llogarinë vjetore të Institutit; 5) te Kuvendi i Institutit propozon shkarkimin e kryetarit të Institutit ose anëtarëve të Këshillit drejtues, në rast të punës së papërgjegjshme dhe jo të rregullt; 6) miraton Rregulloren për punën e Këshillit drejtues; 7) shqyrton raportet për punën e Këshillit drejtues; 8) kryen kontroll ndaj punës së Institutit në përputhje me ligjin, Statutin dhe aktet tjera të Institutit; 9) propozon masa që duhet të ndërmerren për zbatimin dhe mënjanimin e parregullsive dhe paligjshmërive në punën e Institutit; 10) dorëzon raport për punën e tij te Kuvendi i Institutit për miratim; 11) dorëzon raport për punën e tij te Këshilli për t'i informuar dhe 12) kryen punë tjera në përputhje me këtë ligj.
- (7) Në rast të ndërprerjes së parakohshme të mandatit të kryetarit dhe/ose anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës, Kuvendi mundësisht menjëherë dhe më së voni në afat prej 1 abp. 173 - Cnp. 39 30 ditësh nga dita e revokimit, përzgjedh kryetar të ri dhe/ose anëtarë të rinj të Këshillit mbikëqyrës. Deri në përzgjedhjen e kryetarit të ri dhe/ose anëtarit të Këshillit mbikëqyrës, kryetari aktual përaktësisht anëtari i Këshillit mbikëqyrës do ta kryejë funksionin jo më gjatë se gjashtë muaj që nga revokimi.
- (8) Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës kanë të drejtë në kompensim mujor për punën e tyre që nuk duhet ta tejkalojë vlerën e gjysmës së pagës mesatare mujore neto për të punësuar e paguar për muajin dhjetor të vitit paraprak te publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës dhe që paguhet nëse mbahet një mbledhje në muaj për të cilën paguhet kompensimi.

## Neni 20

- (1) Institutin e menaxhon Këshilli drejtues.
- (2) Këshillin drejtues e përbëjnë kryetari dhe katër anëtarë me mandat prej katër vitesh pa të drejtë rizgjedhje. Kryetari i Këshillit drejtues është edhe kryetar i Institutit.

(3) Këshilli drejtues i Institutit: 1) përgatit dhe propozon programi vjetor për punë dhe zhvillim dhe plan vjetor financiar të Institutit; 2) përgatit llogarinë vjetore dhe raportin vjetor për punën e Institutit; 3) propozon vlerën e kompensimit për anëtarësim; 4) propozon vlerën e kompensimit për dhënien e licencës për punë; 5) propozon vlerën e kompensimit për dhënien e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit ose kontabilistit të autorizuar; 6) propozon vlerën e kompensimit për dhënien e provimit për pranimin e kualifikimit profesional të fituar jashtë vendit në përputhje me këtë ligj; 7) vendos për regjistrimin dhe fshirjen e anëtarëve në Regjistrin e Institutit; 8) miraton programin vjetor për përsosje të vazhdueshme profesionale të propozuar nga komisioni për arsim, trajnim dhe publikime; 9) e propozon lartësinë e kompensimit për përsosje të vazhdueshme profesionale; 10) miraton programin vjetor për kontroll të punës së tregtarit individ - kontabilist, tregtarit individ - kontabilist i autorizuar dhe shoqërisë për kryerjen e punëve të kontabilitetit; 11) propozon programin për miratim të kualifikimeve për kontabilist dhe kontabilist i autorizuar të fituara jashtë vendit; 12) shqyron raportet nga kontrolli i kryer i tregtarit individ - kontabilist, tregtarit individ - kontabilist i autorizuar dhe shoqërisë për kryerjen e punëve të kontabilitetit dhe ngren procedurë kundërvajtëse në përputhje me nenin 47 paragrafi (2) nga ky ligj; 13) lëshon dhe heq licenca për punë; 14) propozon anëtarët e komisionit; 15) propozon aktin për vlerën e pagave për kryetarin e Institutit, sekretarin dhe të punësuarit në Shërbimet profesionale të Institutit, si dhe kompensimet për anëtarët e Këshillit drejtues, Këshillit mbikëqyrës, komisioneve dhe Kuvendit të Institutit; 16) vendos për pranimin e donacioneve; 17) kujdeset për pagesën e kompensimit të anëtarësive; 18) kryen vendimet e Këshillit të Institutit; 19) miraton Kodin etik të Institutit; 20) parashtrohet të dhënat e përditësuara nga regjistri i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar, subjekteve që kryejnë punë të kontabilitetit te RRegjistri Qendror më së voni deri në datë 15 janar të vitit rrjedhës për vitin paraprak; 21) parashtrohet të dhënat e përditësuara nga regjistri i kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar te Drejtoria e të Ardhurave Publike së paku një herë në muaj; 22) kryen kontroll dhe përditëson të dhënat në regjistrin e kontabilistëve dhe kontabilistëve të autorizuar që i parashtrohet deri të Regjistri Qendror dhe Drejtoria e të Ardhurave Publike dhe bashkëpunon me ta për zbatim të sukseshëm të rregulloreve të kontabilitetit dhe këtij ligji; 23) miraton akt intern për mënyrën dhe ruajtjen e të dhënave personale dhe informacioneve; 24) kryen punë tjera në përputhje me këtë ligj

(4) Mbledhja e Këshillit drejtues thirret dhe me të udhëheq kryetari i Këshillit. Mbledhja e Këshillit drejtues mund të thirret edhe me kërkesë të shumicës nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit drejtues.

(5) Për plotfuqishmërinë e vendimeve të Këshillit drejtues nevojitet që në mbledhje të jenë të pranishëm shumica nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit drejtues. Vendimet miratohen me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm të Këshillit drejtues.

(6) Nëse kryetari i Institutit për arsye të ndryshme nuk mund ta kryejë funksionin ose mungon, mbledhjet e këshillit drejtues i thërret dhe udhëheq anëtari i Këshillit drejtues i zgjedhur me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Këshillit drejtues.

(7) Vendimet e Këshillit drejtues publikohen në faqen e internetit të Institutit në afat prej 48 orësh nga dita e miratimit të tyre.

(8) Këshilli drejtues për shkak të informimit në nivel tremujor te Këshilli mbikëqyrës parashtrohet raport për punën e tij në afat prej 30 ditësh pas përfundimit të tremujorit.

(9) Anëtarët e Këshillit drejtues kanë të drejtë në kompensim mujor për punën e tyre që nuk duhet ta tejkalojë vlerën e gjysmës së pagës mesatare neto të paguar për muajin dhjetor të vitit

paraparak e publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikave dhe që paguhet nëse mbahet së paku një mbledhje në muaj për të cilën paguhet kompensimi.

#### Neni 21

(1) Kryetari i institutit e kryen funksionin e tij në mënyrë profesionale dhe me orar të plotë dhe ka të drejtë të pagës. Vlera e pagës së kryetarit mund të jetë më së shumti deri në tre paga mesatare mujore neto të paguara për muajin dhjetor të vitit paraparak në përputhje me të dhënat nga Enti Shtetëror i Statistikave.

(2) Kryetari i Institutit: 1) prezenton dhe përfaqëson Institutin; 2) kujdeset që Instituti të punojë në përputhje me ligjin, 3) i zbaton vendimet e Kuvendit të përfaqësuesve nga filialet e Institutit; 4) nënshkruan urdhëresa për pagesë nga llogaria e Institutit; 5) vendos ndaj ankesave sipas masave të shqipëtuara në procedurë disiplinore; 6) zbaton vendimin e miratuar në procedurë disiplinore; 7) kryen punë të tjera të parapara me këtë ligj;

(3) Për kryetar të Institutit mund të përzgjedhet personi që i plotëson këto kushte: 1) ka përvojë pune si kontabilist ose kontabilist i autorizuar, së paku pesë vite radhazi deri në ditën e parashtrimit të kandidaturës. 2) është në marrëdhënie të rregullt pune dhe ka parashtruar program për punë dhe zhvillim të Institutit për mandatin katërvjeçar. 3) të mos jetë i akuzuar në mënyrë ligjore për vepër penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor, ekonomisë dhe detyrës zyrtare. 4) Të mos ketë të shqiptuar ndalesë për kryerjen e detyrimit dhe profesionit, veprimtarisë ose detyrimit dhe

(4) Mandati i kryetarit është katër vjet, pa të drejtë rizgjedhje.

(5) Propozim për revokimin e kryetarit të Institutit te Kuvendi i Institutit parashtronjë së paku gjysma e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit drejtues ose gjysma e përfaqësuesve të përzgjedhur nga filialet e Kuvendit të Institutit ose 10% nga anëtarësia e përgjithshme e Institutit.

(6) Kryetarit të Institutit gjatë kohës së mandatit i pushon marrëdhënia e punës, kurse nuk i pushon anëtarësia në Institut.

#### Neni 22

(1) Anëtarësia në komisione dhe anëtarësia në organet e Institutit mund të ndërpritet para përfundimit të mandatit për të cilin janë emëruar me shkarkim nëse: Crp. 40 - Бр. 173 1 аврест 2022 - anëtari kërkon dhe parashtron dorëheqje te Kuvendi i Institutit; - anëtari e shkel detyrimin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidenciale; - anëtarit i ndërpritet anëtarësia në Institut dhe është fshirë nga regjistri përkatës dhe - mungon në mënyrë të pajustificueshme në tre mbledhje të organeve të Institutit dhe të komisioneve.

(2) Anëtarësia në komisione dhe anëtarësia në organet e Institutit ndërpritet me përfundimin e mandatit, në rast të pamundësisë disamujore ose të përhershme dhe në rast të vdekjes.

(3) Në rast të ndërprerjes së parakohshme të mandatit të anëtarësisë në komisione dhe anëtarësisë në organet e Institutit, Këshilli drejtues në afat prej 60 ditësh nga dita e shkarkimit gjegjësisht nga dita e ndërprerjes sipas paragrafit (2) i këtijë neni, Kuvendit të Institutit i



propozon person tjetër deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të cilit i ndërpritet kryerja e detyrës.

(4) Për ndërprerjen e mandatit në rastet sipas paragrafit (1) të këtij neni, Kuvendi i Institutit miraton vendim për shkarkim në mbledhjen e parë të ardhshme nga paraqitja e shkaqeve të ndërprerjes së mandatit.

(5) Gjatë parashtrimit të dorëheqjes së parevokueshme nga ana e kryetarit të Këshillit drejtues të Institutit, të Këshillit mbikëqyrës dhe të komisioneve të Institutit, deri në përzgjedhjen e kryetarit të ri, funksionin e kryen anëtarit më i moshuar ose komisioni. Gjatë parashtrimit të dorëheqjes së dy të tretave të anëtarëve të Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës ose komisioneve të Institutit, pjesa tjetër e anëtarëve e kryejn detyrimin deri në përzgjedhjen e anëtarëve të rinj.

#### Neni 23

(1) Instituti mjetet e financimit për punën e tij i siguron nga këto burime: 1) kompensim vjetor për anëtarësim nga ushtruesit e punëve të kontabilitetit; 2) kompensime për dhënien e licencave për punë të tregtarit individë - kontabilist, tregtarit individ - kontabilist i autorizuar dhe shoqërisë për kryerjen e punëve të kontabilitetit; 3) kompensime për dhënien e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit ose kontabilistit të autorizuar; 4) kompensime për dhënien e certifikatave për kontabilistin ose kontabilistin e autorizuar; 5) kompensime për dhënien e provimit për pranimin e kualifikimit profesional të fituar jashtë vendit; 6) kompensime nga zbatimi i përsosjes së vazhdueshme profesionale, 7) donacione 8) dënime financiare të paguara për shqiptimin e masave disiplinore.

(2) Kompensimi sipas paragrafit (1) pika (6) të këtij ligji përcaktohet në vlerë prej 5% nga kompensimi neto pa TVSH për secilin pjesëtar në trajnim për përsosjen e vazhdueshme profesionale. Personat juridikë që mbajnë trajnim për përsosje të vazhdueshme profesionale obligohen që të Institutit në nivel tremujor për arsye të përcaktimit të vlerës së kompensimit, të parashtrorin raport për numrin e përgjithshëm të personave të pranishëm gjatë vitit rrjedhës si dhe vlerën e kompensimeve të paguara, më së voni deri në datë 25 të muajit pas përfundimit të çdo tremujori.

(3) Mjetet e siguruar sipas paragrafit (1) të këtij neni Instituti i shfrytëzon për qëllimet në përputhje me planin financiar.

(4) Mjetet e përealizuara nga plani financiar vjetor për vitin rrjedhës transferohen në planin financiar vjetor për vitin e ardhshëm.

#### Neni 24

(1) Instituti detyrohet që të ruajë dhjetë vjet të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e fituara ose krijuara në përputhje me këtë ligj dhe t'i mbrojë të dhënat personale.

(2) Instituti, duke i përfshirë edhe të punësuarit, anëtarët e organeve dhe anëtarët e komisioneve të cilëve u disponohen të dhënat në përputhje me këtë ligj, detyrohen që t'i shfrytëzojnë ato vetëm për qëllime dhe autorizime të përcaktuara me këtë ligj, kurse në veçanti për të dhënat personale, në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhëna personale.

## IV.MËNYRA E MARRJES SË STATUSIT KONTABILIST DHE KONTABILIST I AUTORIZUAR

## Neni 25

Me statusin e kontabilistit ose kontabilistit të autorizuar pajiset personi i cili ka dhënë provimin për marrjen e statusit të kontabilistit ose kontabilistit të autorizuar dhe ka së paku dy vjet përvojë pune në kryerjen e punëve të kontabilitetit nën mentorim të kontabilisti dhe/ose kontabilistit të autorizuar.

## Neni 26

(1)Personi që dëshiron të pajiset me statusin e kontabilistit ose kontabilistit të autorizuar, te Instituti parashtron kërkesë për dhënien e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit ose kontabilistit të autorizuar.

(2) Me kërkesën për dhënien e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit detyrimisht duhet të dorëzohet: 1) Dëshmi (certifikatë) për kryerjen e arsimit të mesëm biznes/ekonomi, ose 2) Dëshmi (certifikatë) për kryerjen e arsimit të lartë biznes/ekonomi shkalla (VI/1), 3) Dëshmi (certifikatë) për kryerjen e arsimit të lartë trevjeçar biznes/ekonomi përkatësisht studime të kryera sipas Kartës së Bolonjës dhe ka 180 kredi sipas Sistemit Europian të Transferimit të Kredive (SETK) 4) Dëshmi (certifikatë) për kryerjen e arsimit të lartë katërvjeçar biznes/ekonomi (shkalla VII/1), përkatësisht studime të kryera sipas Kartës së Bolonjës dhe ka 240 kredi sipas Sistemit Europian të Transferimit të Kredive (SETK) 5) Dëshmi për pagesën e kompensimit për dhënien e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit.

(3) Me kërkesën për dhënien e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit të autorizuar parashtohet: 1) Dëshmi (certifikatë) për kryerjen e arsimit të lartë trevjeçar biznes/ekonomi përkatësisht studime të kryera sipas Kartës së Bolonjës dhe ka 180 kredi sipas Sistemit Europian të transferimit të kredive (SETK) 2) Dëshmi (certifikatë) për kryerjen e arsimit të lartë biznes/ekonomi shkalla (shkalla VI/1), 3) Dëshmi (certifikatë) për kryerjen e arsimit të lartë katërvjeçar biznes/ekonomi (shkalla VII/1), përkatësisht studime të kryera sipas Kartës së Bolonjës dhe ka 240 kredi sipas Sistemit Europian të transferimit të kredive (SETK) 4) Dëshmi për pagesën e kompensimit për dhënien e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit.

(4)Dokumente sipas paragrafit (2) dhe (3) të këtij neni parashtrihen në origjinal ose në kopje të vërtetuar në noter.

(5)Personave që do ta japin provimin për marrjen e statusit të kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar, Instituti u jep certifikatë për kontabilist përkatësisht kontabilist të autorizuar në afat prej 15 ditësh nga dita e dhënies së provimit.

(6)Formën dhe përmbajtjen e kërkesave sipas paragrafit (1) të këtij neni, si dhe formën dhe përmbajtjen e cerifikatave për kontabilist përkatësisht kontabilist të autorizuar e përcakton ministri i Financave.

## Neni 27

(1) Personi që ka certifikatë për kontabilist, përkatësisht certifikatë për kontabilist të autorizuar, evidentohet në Regjistrin e kontabilistëve përkatësisht në Rregjistrin e kontabilistëve të autorizuar në bazë të kërkesës personale të parashtruar te Instituti me formular të përcaktuar në përputhje me paragrafin (9) të këtij neni.

(2) Me kërkesën për regjstrim në regjistrat sipas paragrafit (1) të këtij neni parashtrohen këto dokumente: 1) certifikatë për kontabilist, përkatësisht kontabilist të autorizuar: 1 абрь 2022 Бр. 173 - Стр. 41 2) dëshmi se nuk i është shqiptuar sanksion kundërvajtës për ndalesë të kryerjes së profesionit ose detyrimit nga sfera e financave, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë, për sa kohë që zgjasin pasojat juridike nga sanksionet: 3) dëshmi se me aktgjykim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënim dytësor për ndalesë të kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrimit për vepra penale kundër marrëdhënieve të punës përkatësisht vepra penale kundër pronës, vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë dhe vepra penale kundër detyrimit zyrtar, për sa kohë që zgjasin pasojat juridike nga aktgjykimi dhe 4) dëshmi se me aktgjykim të plotfuqishëm nuk është dënuar me burgim të pakushtëzuar mbi gjashtë muaj, për vepra penale kundër marrëdhënieve të punës, përkatësisht vepra penale kundër pronës, vepra penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë dhe vepra penale kundër detyrimit zyrtar, për sa kohë që zgjasin pasojat juridike nga aktgjykimi. 5) dëshmi për pagesën e kompensimit të anëtarësisë dhe 6) dëshmi për përvojën e punës në kryerjen e punëve të kontabilitetit prej dy vitesh, të fituar në bazë të punësimit dhe/ose praktikës në përputhje me ligj dhe nën mentorim të kontabilistit dhe/ose kontabilistit të autorizuar.

(3) Dëshmi për përvojën lidhur me kryerjen e punëve të kontabilitetit sipas paragrafit (2) pika 6) të këtij neni përfshin vërtetimin nga punëdhënsi përvojën e fituar në kryerjen e punëve të kontabilitetit dhe dëshminë nga evidenca e organit për punësim. Dëshmia lidhur me përvojën, parashtrohet vetëm nëse personi ka fituar përvojë para parashtrimit të kërkesës për regjstrim në Regjistrin përkatës.

(4) Dokumentet sipas paragrafit (2) pika 1) të këtij ligji sigurohen nga evidenca e Institutit në mënyrë zyrtare me kërkesë të personit sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(5) Personi i autorizuar zyrtar nga Instituti që udhëheq procedurën për regjistrimin në regjistrat sipas paragrafit (1) të këtij neni obligohet që në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimi të kërkesës, dokumentet sipas paragrafit (2) pikat 2), 3), dhe 4) të këtij neni në mënyrë zyrtare t'i kërkojë nga RRegjistri Qendror, kurse dëshmitë sipas paragrafit (2) pika 6) të këtij neni në mënyrë zyrtare t'i kërkojë nga Agjencia e punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(6) Personi i autorizuar zyrtar nga RRegjistri Qendror, përkatësisht Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut nga i cili është kërkuar dokumenti obligohet që të atë ta parashtojë te Instituti në afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimi të kërkesës sipas paragrafit (5) të këtij neni.

(7) Instituti obligohet që personin sipas paragrafit (1) të këtij neni ta regjistrojë në Rregjistrin përkatës në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(8) Dispozitat sipas paragrafit (2) të këtij neni nuk zbatohen për ofruesit e shërbimeve të kontabilitetit të regjistruar në shtetet anëtare të Zonës ekonomike europiane.

(9) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës sipas paragrafit (1) të këtij neni, si dhe formën dhe përmbajtjen e vërtetimit për përvojën e fituar në kryerjen e punëve të kontabilitetit sipas paragrafit (2) pika 6) të këtij neni i përcakton ministri i Financave.

## Neni 28

(1) Dhënia e provimit për marrjen e statusi të kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar, zbatohet sipas programit për dhënien e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar të cilin e miraton Këshilli drejtues i Institutit pas miratimit paraprak të Këshillit.

(2) Me programin sipas paragrafit (1) të këtij neni përcaktohen lëndët, rregulloret dhe literatura për dhënien e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar. Programi duhet të harmonizohet me programin për marrjen e titujve të ngjashme profesionale të organeve të tjera profesionale dhe programeve mësimore nga sfera e kontabilitetit nga institucionet arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriu.

(3) Lëndët e programit sipas paragrafit (1) të këtij neni në veçanti duhet t'i përfshijë këto sfera: 1) kornizë ligjore lidhur me përpilimin e llogarive vjetore dhe raporteve financiare dhe llogarive vjetore të konsoliduara dhe raporteve financiare, standardeve ndërkombëtare për raportim financiar, 2) financa dhe analizë financiare dhe 3) tatime dhe sistem tatimor.

(4) Provimin për marrjen e statusit të kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar e zbaton komisioni i provimit i formuar nga ana e Institutit. Komisioni i provimit përbëhet prej pesë anëtarëve nga rradhët e kontabilistëve, kontabilistëve të autorizuar, profesorëve universitarë nga sfera e kontabilitetit dhe revizionit me pesë vjet përvojë pune në sferën e kontabilitetit, financave, tatimeve, të drejtës korporative dhe marrëdhënieve të punës. Sipas nevojës, Instituti mund të formojë disa komisione për zbatimin e provimit të formuar nga ana e Kuvendit të Institutit.

(5) Mënyrën për zbatimin e provimit për marrjen e statusit të kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar në mënyrë të detajuar e përcakton Këshilli drejtues i Institutit pas pëlqimit paraprak të Këshillit.

(6) Personi që jep provimin për marrjen e certifikatës për kontabilist, përkatësisht kontabilist të autorizuar mund të lirohet nga provimi nga lëndët e caktuara që i ka dhënë gjatë arsimimit paraprak në bazë të dokumentacionit të parashtruar për dhënien e provimeve dhe programit mësimor, për të cilin vendos komisioni i provimeve.

(7) Me përjashtim të paragrafit (6) të këtij neni, personi i cili e jep provimin për marrjen e certifikatës së kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar, do të lirohet nga marrja e lëndëve që i ka kaluar gjatë shkollimit paraprak dhe/ose pas, dhe të cilat lëndë janë të akredituara nga ASSA në institucionet që kanë zbatuar provimin.

(8) Komisioni i provimit sipas paragrafit (4) të këtij neni ka të drejtë në kompensim financiar me vlerë deri në 50% të një page mesatare neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për muajin e fundit nga viti paraprak e publikuar nga Enti shtetëror i statistikave.

(9) Kompensimi financiar sipas paragrafit (8) të këtij neni paguhet për anëtarët e pranishëm për secilën mbledhje të mbajtur të punës së komisionit për të cilën paguhet kompensimi. Vlera vjetore e kompesimit financiar të paguar nuk mund ta tejkalojë vlerën vjetore të pagës mesatare neto të paguar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për muajin e fundit nga viti paraprak e publikuar nga Enti shtetëror i statistikave.

## Neni 29

- (1) Personi që ka licencë për revizor të autorizuar mund të fitojë statusin e kontabilistit të autorizuar pa dhënien e provimit profesional.
- (2) Personi sipas paragrafit (1) të këtij neni për marrjen e statusit të kontabilistit të autorizuar te Instituti obligohet që të parashtrorë kërkesë me të cilën parashtron edhe: 1) licencë për revizor të autorizuar në original ose kopje të vërtetuar në noter, dhe 2) dëshmi për pagesën e kompensimit për dhënien e certifikatës për kontabilist të autorizuar.
- (3) Instituti i jep certifikatë për kontabilist të autorizuar personit sipas paragrafit (1) të këtij neni në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.
- (4) Revizori i autorizuar që pajiset me certifikatën për kontabilist të autorizuar nuk mund të kryejë punët e kontabilistit të autorizuar dhe punët e revizorit të autorizuar me të njëjtin subjekt.
- (5) Punët e kontabilitetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut mund t'i kryejë edhe personi që ka fituar kualifikim jashtë vendit nëse: 1) kualifikimi profesional i fituar jashtë vendit është i përshtatshëm me kualifikimin profesional të fituar në përputhje me këtë ligj dhe 2) gjatë procedurës së verifikimit të aftësisë profesionale të zbatuar nga Instituti me sukses jep provimin e zbatuar nga ana e Institutit në përputhje me nenin 16 pika 9) nga ky ligj me të Crp. 42 - Бр. 173 1 аврyст 2022 cilin vërtetohet se ka njohuri nga sfera e rregullativës ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut për kryerjen e punëve të kontabilitetit.
- (6) Personi sipas paragrafit (5) të këtij neni te Instituti parashtron kërkesë për pranimin e kualifikimit të fituar jashtë vendit me të cilën veçanërisht i parashtron këto dokumente: 1) diplomë për arsimim të kryer 2) certifikatë të nënshtetësisë 3) dokument i lëshuar prej organit kompetent lidhur me kualifikimin profesional të personit, 4) program sipas të cilit është fituar kualifikimi profesional jashtë vendit dhe 5) dëshmi për pagesën e kompensimit për zbatimin e procedurës për pranimin e kualifikimit profesional të fituar jashtë vendit.
- (7) Dokumentet sipas paragrafit (6) të këtij neni personi i parashtron në original ose në kopje të vërtetuar në noter, përkatësisht me përkthim të vërtetuar në noter.
- (8) Instituti i jep certifikatë personit sipas paragrafit (5) të këtij neni në afat prej 15 ditësh nga dita e plotësimit të kushteve nga paragrafet (5) dhe (6) të këtij neni.
- (9) Mënyrën e pranimit të kualifikimit profesional kontabilist përkatësisht kontabilist të autorizuar të fituar jashtë vendit në mënyrë të detajuar e përcakton ministri i Financave. (10) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për pranimin e kualifikimit profesional të fituar jashtë vendit i përcakton ministri i Financave.

#### IV. PËRSOSJA E VAZHDUESHME PROFESIONALE

##### Neni 30

- (1) Për shkak të përmirësimit të njohurive në sferën e kontabilitetit, kontabilistët detyrohen të ndjekin trajnim për përsosje të vazhdueshme profesionale prej së paku 90 ditë për periudhë prej tri viteve, me të paktën 24 orë gjatë një viti edhe atë cikli i parë prej tri viteve, përkatësisht viti i parë në të cilin fillon të zbatohet ky detyrim është viti që vijon pas vitit në të cilin kontabilisti është i regjistruar në regjistrin e kontabilistëve.

(2) Për shkak të përmirësimit të njohurive në sferën e kontabilitetit, kontabilistët e autorizuar janë të detyruar që të ndjekin trajnim për përsosje të vazhdueshme profesionale prej së paku 120 orë për periudhë prej tri viteve, me ç'rast të paktën 32 orë gjatë një viti edhe atë cikli i parë prej tre viteve, përkatësisht viti i parë në të cilin fillon të zbatohet ky detyrim është viti që vijon pas vitit në të cilin kontabilisti është i regjistruar në regjistrin e kontabilistëve.

(3) Përsosja e vazhdueshme profesionale sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni kryhet sipas rregullores dhe programit vjetor të përsosjes së vazhdueshme profesionale, të miratuar nga Kuvendi i Institutit, që është i harmonizuar me programet për përsosje të vazhdueshme profesionale të organeve të tjera profesionale në fushën e kontabilitetit, revizionit, financave, tatimeve dhe marrëdhënieve të punës.

(4) Përsosja e vazhdueshme profesionale sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, zbatohet veçanërisht nëpërmjet: 1) trajnimeve në sferën e standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar dhe rregullativës në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që është relevante për kryerjen e punëve të kontabilitetit, 2) pranisë në seminarët ndërkombëtare, punëtoritë, simpoziumet dhe llojet e tjera të edukimit të organizuar, të miratuara paraprakisht nga Instituti, 3) pjesëmarrjes si ligjerues në ngjarjet në pikat 1) dhe 2) të këtij paragrafi, 4) publikimit të artikujve në publikacionet vendore me katalogim në BNU dhe publikacionet profesionale ndërkombëtare, të miratuara paraprakisht nga Instituti, 5) mentorimit në trajnim praktik në sferën e kontabilitetit të studentëve me marrëveshje të nënshkruar ndërmjet Institucionit dhe personit fizik kontabilist i autorizuar – mentor, kontabilistit – mentor ose tregtarit individ – kontabilist i autorizuar, tregtarit individ – kontabilist, 6) mentorimit të magistrave dhe doktorantëve në sferën e kontabilitetit dhe revizionit me marrëveshje të nënshkruar ndërmjet Institucionit dhe personit fizik kontabilist të autorizuar – mentor, kontabilistit – mentor ose tregtarit individ – kontabilist i autorizuar, tregtarit individ – kontabilist, 7) mentorimin në trajnimin praktik në fushën e kontabilitetit dhe revizionit të praktikantit të kontabilitetit i cili është i punësuar ose ka statusin e praktikantit në pajtim me këtë ligj dhe 8) forma të tjera të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të përcaktuara me akt të Institutit në pajtim me këtë ligj.

(5) Trajnimet në paragrafin (4) pikën 1) të këtij neni i kryejnë Instituti dhe personat juridikë, që ofrojnë shërbime këshilluese dhe edukim në sferën e kontabilitetit, financave, tatimeve, së drejtës së korporatave dhe marrëdhënieve të punës, që kanë leje për kryerjen e trajnimeve për përsosje të vazhdueshme profesionale të lëshuar nga Instituti dhe janë regjistruar në Regjistrin e personave juridikë, që kryejnë trajnime për përsosje të vazhdueshme profesionale.

(6) Personave juridikë që ofrojnë shërbime këshillimi dhe edukimi në sferën e kontabilitetit, financave, tatimeve, së drejtës së korporatave dhe marrëdhënieve të punës, u lëshohet leje për kryerjen e trajnimit për përsosje të vazhdueshme profesionale pas kërkesë së parashtruar paraprakisht te Instituti nëse: kanë punësuar të paktën dy kontabilistë të autorizuar me të paktën pesë vjet përvojë pune në sferën e kontabilitetit dhe përvojë prej tri viteve në organizimin dhe kryerjen e trajnimeve në sferën e kontabilitetit, financave, tatimeve, e së drejtës së korporatave dhe marrëdhënieve të punës.

(7) Leja sipas paragrafit (5) të këtij neni, u lëshohet të gjithë personave juridikë, që i plotësojnë kushtet sipas paragrafit (6) të këtij neni.

(8) Kontabilisti, përkatësisht kontabilisti i autorizuar është i obliguar që së paku 60% të orëve për periudhë prej tre vjetësh në pajtim me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni t'i realizojë nëpërmjet trajnimeve të dëshmuara që mund të konfirmohen dhe kontrollohen, e minimum 20 orë në vit duke ndjekur trajnimet sipas paragrafit (4) pika 1) e këtij neni.

(9) Trajnimi sipas paragrafit (4) pika (1) të këtij neni zhvillohet me prani fizike në hapësira që plotësojnë kushtet hapësinore dhe teknike me qasje adekuate didaktike për mësimdhënie të përshtatur ndaj profilit dhe numrit të auditoriumit ose mësimdhënies online në bazë të platformës profesionale, që e mundëson atë, me regjistrim të saktë për ndjekjen e trajnimit.

(10) Kushtet hapësinore dhe teknike sipas paragrafit (9) të këtij neni, që duhet të plotësohen nga Instituti dhe personat juridikë për përsosje të vazhdueshme profesionale, si dhe mënyra për realizimin e trajnimeve për përsosje të vazhdueshme profesionale, përcaktohen nga Këshilli drejtues i Institutit.

(11) Rregulloren dhe programin vjetor për përsosje të vazhdueshme profesionale, mënyrën e zhvillimit të trajnimeve, mënyrën e vlerësimit, njohjes dhe vërtetimit të përsosjes së vazhdueshme profesionale, arsyet e arsyeshme të mungesës nga përsosja e vazhdueshme profesionale, format tjera të përsosjes së vazhdueshme profesionale, kryerjen e zhvillimit profesional dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me organizimin dhe zbatimin e përsosjes së vazhdueshme profesionale, i përcakton Këshilli Drejtues i Institutit me pëlqimin paraprak të Komisionit për Arsim, Trajnim dhe Publikime pranë Institutit.

(12) Rregullorja dhe programi vjetor për përsosje të vazhdueshme profesionale harmonizohen me standardin për arsim së paku një herë në vit.

## V. KRYERJA E PUNËVE TË KONTABILITETIT DHE PARASHTRIMI I LLOGARISË VJETORE

### Neni 31

(1) Përmbajtja e punëve të kontabilitetit, qëllimet themelore, kryesore dhe ato shtesë, detyrat dhe lëndën për kryerjen e punëve të kontabilitetit, përcaktohen nga 1 август 2022 Бр. 173 - Стр. 43 Këshilli drejtues i Institutit. Kontabilisti dhe/ose kontabilisti i autorizuar, i cili posedon certifikatë për kontabilist ose konstabilist të autorizuar nga Instituti dhe është i regjistruar në regjistrin përkatës të Institutit në kuadër të statusit që e ka, fitohet me të drejtën e kryerjes së punëve të kontabilitetit, si dhe me të drejtën e nënshkrimit të të gjitha dokumenteve për raportim financiar, që janë si rezultat i kryerjes së punëve të kontabilitetit.

(2) Kontabilisti mban librat tregtare/afariste të obliguesve për udhëheqjen e kontabilitetit, për tregtarët individë, shoqatat dhe fondacinë dhe/ose përpilon dhe nënshkruan për t llogarinë vjetore dhe/ose raportet financiare në formë me shkrim dhe në formë elektronike.

(3) Kontabilisti i autorizuar mban librat tregtare/afariste të të gjithë obliguesve për udhëheqjen e kontabilitetit dhe/ose përpilon dhe nënshkruan për ta llogarinë vjetore dhe/ose raportet financiare në formë në letër dhe në formë elektronike.

(4) Kontabilisti, përkatësisht kontabilisti i autorizuar në mënyrë të detyruar nënshkruan llogarinë vjetore dhe fletëparaqitjet tatimore e obliguesit për të cilin mban libra tregtare/afariste, ku shënon datën e përpilimit dhe nënshkrimin të tyre dhe numrin e regjistrimit me të cilin është regjistruar në regjistrin e kontabilistëve dhe regjistrin e kontabilistëve të autorizuar.

(5) Për punët e kontabilitetit, obliguesi sa i përket udhëheqjes së kontabilitetit, mund të punësojë ushtrues të punëve të kontabilitetit ose praktikant të kontabilitetit, i cili nuk ka të drejtë që të nënshkruajë llogari vjetore dhe/ose raporte financiare.

(6) Sa i përket qëllimeve të raportimit financiar, obliguesi për udhëheqjen e punëve të kontabilitetit mund të punësojë kontabilist dhe/ose kontabilist të autorizuar me orar të plotë të punës. Obliguesit për udhëheqjen e punëve të kontabilitetit, të cilët sipas Ligjit të Shoqërive Tregtare janë persona të ndërlidhur, mund të punësojnë të njëjtin person me orar të shkurtuar të punës.

(7) Kontabilisti i punësuar dhe/ose kontabilisti i autorizuar nënshkruan llogarinë vjetore dhe fletëparaqitjet tatimore vetëm për obliguesin për udhëheqjen e punëve të kontabilitetit ku punon ose personat e lidhur me të, me ç'rast shënon datën e përpilimit dhe nënshkrimin të tyre dhe numrin e regjistrimit me të cilin është regjistruar në regjistrin e kontabilistëve dhe regjistrin e kontabilistëve të autorizuar.

(8) Obliguesi për udhëheqjen e kontabilitetit me marrëveshje për kryerjen e punëve të kontabilitetit mund të angazhojë tregtar individ – kontabilist, tregtar individ – kontabilist të autorizuar ose shoqëri për kryerjen e punëve të kontabilitetit, që ka Licencë për punë, të lëshuar nga Instituti.

(9) Tregtari individ – kontabilist mund të nënshkruajë marrëveshje për kryerjen e punëve të kontabilitetit me ushtruesin e pavarur të veprimtarisë, bashkësinë e pronarëve të pjesëve të veçanta të ndërtesës, tregtarin individ, shoqërinë, fondacionin dhe institucionin privat.

(10) Tregtari individ – kontabilisti i autorizuar mund të nënshkruajë marrëveshje për kryerjen e punëve të kontabilitetit me të gjithë obliguesit për udhëheqjen e punëve të kontabilitetit, përveç me shoqërinë publike tregtare, shoqërinë komandite, shoqërinë aksionare dhe shoqërinë komandite me aksione.



(11) Shoqëria për kryerjen e punëve të kontabilitetit nënshkruan marrëveshje për kryerjen e punëve të kontabilitetit me të gjithë obliguesit për kryerjen e punëve të kontabilitetit.

(12) Shoqëria për kryerjen e punëve të kontabilitetit duhet të ketë të punësuar së paku një kontabilist të autorizuar.

(13) Tregtari individ – kontabilist, tregtari individ – kontabilist i autorizuar ose shoqëria për kryerjen e punëve të kontabilitetit gjatë vlefshmërisë së marrëveshjes nuk mund t'ia transferojë punët e kontraktuara pronarit tjetër individ – kontabilist, tregtarit individ – kontabilist të autorizuar ose shoqërisë për kryerjen e punëve të kontabilitetit, pa pëlqimin e obliguesit për kryerjen e punëve të kontabilitetit.

### Neni 32

(1) Tregtari individ ose shoqëria tregtare mund të kryejë punët e kontabilitetit pas marrjes së licencës për punës nga Instituti me regjistrim të kryer në regjistrin përkatës të Institutit.

(2) Për marrjen e licencës për punë, personi juridik parashton kërkesë në Institutin. Me kërkesën dorëzon edhe dokumentacionin e mëposhtëm: 1) aktvendim për regjistrim në Regjistrin Qendror, 2) aktvendim për statusin e kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar në emër të parashtruesit të kërkesës, 3) listën e të punësuarve që ushtrjnë punët e kontabilitetit, numrin e regjistrimit me të cilin janë regjistruar në regjistrin përkatës të Institutit me shënimin e personave që kanë të drejtën e përpilimit dhe nënshkrimit të llogarisë vjetore dhe/ose raporteve financiare, 4) dëshmitë sipas nenit 27 paragrafi (2) pikat 2), 3) dhe 4) të këtij ligji, 5) dëshmi se është hapur ose inicuar procedurë të falimentimit ose likuidimit, 6) dëshmi për sigurim vjetor gjatë kryerjes së punëve të kontabilitetit, edhe atë për: - tregtarin individ – kontabilist, vlerë minimale prej 2.000 eurove në kundërvlerë denari për ngjarje të dëmtimit, - tregtar individ – kontabilist i autorizuar në shumë prej minimum 10.000 eurove në kundërvlerë denari për rastin e dëmtimit, - shoqëri për kryerjen e punëve të kontabilitetit në shumë prej minimum 20.000 në kundërvlerë denari për rastin e dëmtimit dhe 7) dëshmi për kompensim të paguar për lëshimin e licencës për punë.

(3) Personi i autorizuar zyrtar nga Instituti, që zhvillon procedurën për lëshim të Licencës për punë të personave juridikë, është i obliguar që dokumentet sipas paragrafit (2) pikat 1), 4) dhe 5) të këtij neni, sipas detyrës zyrtare t'i kërkojë nga Regjistri Qendror brenda 15 ditëve nga dita e pranimit së kërkesës.

(4) Personi i autorizuar zyrtar nga Regjistri Qendror nga i cili kërkohen dokumente është i obliguar ato t'i dorëzojë në Institutin brenda shtatë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës sipas paragrafit (2) të këtij neni.

(5) Dokumentet sipas paragrafit (2) pikat 3) dhe 6) të këtij neni, dorëzohen në origjinal ose kopje të noterizuar.

(6) Instituti miraton aktvendim për lëshimin e licencës për punë dhe në bazë të aktvendimit për lëshimin e licencës për punë të personave juridikë sipas formës dhe statusit të tyre ligjor i regjistron në Regjistrin përkatës në Institutin brenda 30 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës nga pikat (2) dhe (3) të këtij neni.

- (7) Licenca për punë lëshohet me kohë të pacaktuar dhe nuk mund t'i bartet personit tjetër fizik ose juridik ose pasardhësit juridik.
- (8) Tregtari individ – kontabilist, tregtari individ – kontabilist i autorizuar, shoqëria për kryerjen e punëve të kontabilitetit mund të punojë pas regjistrimit të kryer të licencës për punë në Regjistrin Qendror brenda 15 ditëve nga dita e marrjes së licencës.
- (9) Personat juridikë me licencë për punë detyrohen jo më vonë se 31 janari të vitit rrjedhës ta dorëzojnë në Institut listë të personave të punësuar me titujt e tyre, me numrin e tyre të regjistrimit me të cilin janë regjistruar në regjistrin përkatës të Institutit dhe dëshmi për sigurimin vjetor nga dëmi gjatë kryerjes së veprimtarisë profesionale në vlerë të përcaktuar në paragrafin (2) pika 6) të këtij neni.
- (10) Licenca për punë të personit juridik hiqet nëse: 1) parashtrohet kërkesë; 2) licenca është lëshuar në bazë të të dhënave të pasakta; 3) nuk plotësohen më kushtet në bazë të të cilave është lëshuar licenca; 4) është inicuar procedura për likuidim ose falimentim 5) është shqiptuar sansioni kundërvajtës ndalimi i kryerjes së veprimtarisë së kontabilitetit; 6) kontabilisti, përkatësisht kontabilisti i autorizuar fshihet nga regjistri përkatës sipas nenit 36 të këtij ligji; 7) është shqiptuar dënim dytësor, ndalim i përkohshëm i kryerjes së veprimtarisë së kontabilitetit; 8) është shqiptuar dënim dytësor, heqje e licencës për kryerjen e veprimtarisë së kontabilitetit; 9) është shqiptuar dënim dytësor, ndalesë e përhershme për kryerjen e veprimtarisë së kontabilitetit dhe Стр. 44 - Бр. 173 1 август 2022 10) është shqiptuar dënimi dytësor, ndalesë për punë të personit juridik.
- (11) Në rastet sipas paragrafit (10) pika 1) të këtij neni, licenca hiqet brenda pesë ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës.
- (12) Në rastet sipas paragrafit (10) pika 2) e këtij neni, licenca hiqet nga ana e Institutit menjëherë pas përcaktimit të faktit se licenca është e lëshuar në bazë të të dhënave të pasakta. Licenca hiqet për periudhë prej tri viteve nga dita e heqjes së licencës.
- (13) Në rastet sipas paragrafit (10) pika 3) të këtij neni, licenca hiqet menjëherë pasi Instituti ka konstatuar se ndonjë nga kushtet shfuqizohet për lëshimin e licencës, përveç në rastin kur mosplotësimi i ndonjë prej kushteve është për shkak të një ngjarjeje, që nuk mund të parashikohej, parandalohej ose shmangej, me ç'rast licenca hiqet brenda 30 ditëve nga dita kur Instituti ka konstatuar se kushti është shfuqizuar.
- (14) Në rastet sipas paragrafit (10) pika 4 dhe paragrafi (2) pika 5) të këtij neni, licenca hiqet duke përfshirë ditën e hapjes së procedurës së falimentimit ose procedurës së likuidimit.
- (15) Në rastin sipas paragrafit (10) pika 5) të këtij neni, licenca hiqet me ditën e hyrjes në fuqi të vendimit për sanksionin e kundërvajtjes. Licenca hiqet për periudhën sa zgjasin pasojat ligjore të ndalimit.
- (16) Në rastin sipas paragrafit (10) pika 6) të këtij ligji, licenca hiqet në ditën e fshirjes nga regjistri përkatës. Licenca hiqet për periudhën për të cilën humbet e drejta e kryerjes së punëve të kontabilitetit sipas nenit 36 paragrafi (2) të këtij ligji.
- (17) Në rastin sipas paragrafit (10) pika 7) të këtij neni, licenca hiqet në ditën e hyrjes në fuqi të vendimit. Licenca hiqet për periudhën ndërkohë që zgjasin pasojat ligjore të vendimit gjyqësor.
- (18) Në rastet sipas paragrafit (10) pikat 8), 9) dhe 10) të këtij neni, licenca hiqet në ditën e hyrjes në fuqi të vendimit të gjykatës.
- (19) Aktvendimi për heqjen e licencës, që miratohet nga Instituti, duhet të aryetohet.
- (20) Kundër Aktvendimit sipas paragrafit (19) të këtij neni, mund të inicohet kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditëve nga data e pranimit.

(21) Padia nuk vonon zbatimin e aktvendimit sipas paragrafit (19) të këtij neni.

(22) Personit juridik të të cilit i është hequr licenca mund të parashtrojë kërkesë për lëshimin e licencës së re për punë pas përfundimit të afatit sipas paragrafit (12) të këtij neni, për periudhën e së cilës është hequr përkohësisht licenca për punë.

### Neni 33

(1) Punët e kryerjes së kontabilitetit mund t'i kryejë edhe personi fizik ose juridik i huaj nga vendet anëtare të Zonës ekonomike europiane i cili i plotëson kushtet për kryerjen e punëve të kontabilitetit, përkatësisht ka licencë për kryerjen e punëve të kontabilitetit nga organi kompetent i vendit anëtar i Zonës ekonomike europiane, në përputhje me këtë ligj.

(2) Instituti i lëshon certifikatë personit fizik nga paragraf (1) të këtij neni për kontabilist, përkatësisht kontabilist të autorizuar sipas procedurës së nenit 26 të këtij ligji, nëse në shtojcë të kërkesës dorëzohet: 1) dokument i lëshuar nga organi kompetent i vendit anëtar të Zonës ekonomike europiane sa i përket kualifikimit profesional të personit. 2) vërtetim nga organi kompetent i vendit anëtar të Zonës ekonomike europiane se nuk është shqiptuar ndalesë për kryerjen e profesionit ose veprimtarisë, jo më të vjetër se tre muaj.

(3) Instituti me aktvendim do ta regjistrojë personin juridik sipas paragrafit (1) të këtij neni në Regjistrin e shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilitetit, nëse: 1) së paku një kontabilist i autorizuar i punësuar në personin juridik ka certifikatë të kontabilitetit të autorizuar të lëshuar nga Instituti sipas paragrafit (2) të këtij neni, 2) ka leje për punë, përkatësisht është i regjistruar në regjistrin e organit kompetent të vendit anëtar të Zonës ekonomike europiane, ku leja e punës, përkatësisht certifikata e regjistrimit të mos jetë më e vjetër se tre muaj, 3) vërtetim nga organi kompetent i vendit anëtar të Zonës ekonomike europiane se nuk është shqiptuar masë ndalimi për kryerjen e veprimtarisë, jo më i vjetër se tre muaj dhe 4) ka dëshmi për sigurimin vjetor nga dëmi gjatë kryerjes së veprimtarisë profesionale (punët e kontabilitetit), sipas nenit 32 paragrafi (2) pika 6) të këtij ligji.

(4) Instituti i kryen regjistrimin e personit juridik sipas paragrafit (1) të këtij neni në regjistrin përaktës në përputhje me nenin 27 të këtij ligji.

(5) Instituti sa i përket regjistrimit sipas paragrafit (4) të këtij neni detyrohet që ta informojë organin e vendit anëtar të Zonës ekonomike europiane. Neni 34 Kontabilisti, kontabilisti i autorizuar, tregtari individ – kontabilist, tregtari individ – kontabilisti i autorizuar, përkatësisht shoqata për kryerjen e punëve të kontabilitetit janë të pavarur në kryerjen e punëve të kontabilitetit.

## VI. REGJISTRAT

### Neni 35

(1) Instituti mban regjistrat e mëposhtme: 1) Regjistri i praktikantëve të kontabilitetit, 2) Regjistri i kontabilistëve, 3) Regjistri i kontabilistëve të autorizuar, 4) Regjistri i tregtarëve individë – kontabilistë, 5) Regjistri i tregtarëve individë – kontabilistë të autorizuar, 6) Regjistri

i shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilitetit dhe 7) Regjistri i personave juridikë që zbatojnë trajnime për përsosje të vazhdueshme profesionale

(2) Regjistri i praktikantëve të kontabilitetit përfshin veçanërisht të dhënat e mëposhtme: 1) emri dhe mbiemri dhe numri i regjistrimit të personit; 2) data dhe regjistrimi në Regjistër; 3) emri, selia dhe të dhënat e kontaktit për person fizik, përkatësisht juridik ku punon dhe 4) statusi i mentorit dhe numri i certifikatës së tij;

(3) Regjistri i kontabilistëve dhe Regjistri i kontabilistëve të autorizuar veçanërisht i përfshin të dhënat e mëposhtme: 1) emri dhe mbiemri dhe numri i regjistrimit të personit; 2) shënimi i së drejtës për nënshkrimin e llogarisë vjetore dhe/ose raporteve financiare; 3) data e regjistrimit në Regjistër; 4) emri, selia dhe të dhënat e kontaktit të personit juridik ku punon; 5) numri i orëve të realizuara për përsosje të vazhdueshme profesionale, në nivel vjetor dhe për periudhën vjeçare dhe 6) masa të shqiptuara disiplinore.

(4) Regjistri i tregtarëve individë – kontabilistë, Regjistri i tregtarëve individë – kontabilistë të autorizuar dhe Regjistri i shoqatave për kryerjen e punëve të kontabilitetit, veçanërisht i përfshin të dhënat e mëposhtme: 1) emri, selia, të dhënat e kontaktit dhe numri i regjistrimit të tregtarit individ – kontabilist, tregtarit individ – kontabilist i autorizuar dhe shoqatës për kryerjen e punëve të kontabilitetit; 2) data e regjistrimit në regjistër dhe 3) masat e shqiptuara disiplinore.

(5) Regjistri i personave juridikë, që kryejnë trajnime për përsosje të vazhdueshme profesionale veçanërisht përfshin të dhënat e mëposhtme: 1) numri i regjistrimit, 2) emri, selia dhe të dhënat e kontaktit të personit që kryen trajnimet dhe 3) numri i aktvendimit të lëshuar nga Instituti. 1 аврыст 2022 Бр. 173 - Срп. 45

(6) Të gjithë personat fizikë dhe juridikë të regjistruar në regjistrat përaktës obligohen ta informojnë Institutin për të gjitha ndryshime lidhur me të dhënat e përfshira në Regjistrin në afat prej 15 ditëve nga dita e ndryshimit.

(7) Instituti i mban regjistrat sipas paragrafit (1) të këtij neni edhe në mënyrë elektronike, me ç'rast të dhënat i publikon në faqen e tij të internetit dhe ato të dhëna i përditëson në mënyrë të vazhdueshme.

(8) Forma, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes së regjistrave sipas paragrafëve (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni, përcaktohen nga ministri i Financave.

### Neni 36

(1) Kontabilisti, përkatësisht kontabilisti i autorizuar fshihet nga Regjistri përkatës: 1) me kërkesë të tij; 2) nëse gjatë regjistrimit në Regjistër ka dhënë të dhëna të pasakta; 3) nëse nuk e paguan kompensimin vjetor të anëtarësismit; 4) nëse është dënuar me aktgjykim të plotfuqishëm me burgim të pakushtëzuar mbi gjashtë muaj për veprat penale kundër pronës, vepra penale kundër financave publike, qarkullimit të pagesave dhe ekonomisë dhe vepra penale kundër detyrës zyrtare, për sa kohë që zgjasin pasojat juridike nga aktgjykimi 5) nëse nuk është shqiptuar sanksion për kundërvajtje për kryerjen e profesionit ose detyrën në sferën e financave, qarkullimit të pagesave dhe ekonomisë; 6) nëse me aktgjykim të plotfuqishëm është shqiptuar dënim dytësor ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës për vepra penale kundër marrëdhënieve të punësmit, vepra penale kundër pronës, vepra penale kundër financave publike, qarkullimit të pagesave dhe ekonomisë dhe vepra penale kundër detyrës

zyrtare për sa kohë që zgjasin pasojat juridike nga aktgjykimi; 7) nëse është hequr aftësia për punë; 8) në rast të vdekjes së personit fizik dhe 9) nëse personi fizik realizon të drejtën e pensionimit

(2) Me fshirjen nga regjistri, personi fizik humb të drejtën e kryerjes së punëve të kontabilitetit edhe atë: 1) në mënyrë të përhershme në rastet sipas paragrafit (1) pikat 1), 2), 7) dhe 9) të këtij neni; 2) për periudhë prej tri viteve në rastet sipas paragrafit (1) pika 3) të këtij neni dhe 3) për periudhën sa zgjasin pasojat juridike të aktgjykimit, përkatësisht për periudhën sa zgjat ndalimi në rastin sipas paragrafit (1) pikat 5) dhe 6) të këtij neni.

(3) Dispozitat sipas paragrafit (1) pika 3) dhe paragrafi (2) pika 2) të këtij neni nuk zbatohen nëse kontabilisti, përkatësisht kontabilisti i autorizuar fshihet ose emërohet në funksion publik për periudhën e mandatit të tij.

(4) Për fshirjen nga regjistri përaktës, Këshilli drejtues i Institutit miraton aktvendim që duhet të arsyetohet.

(5) Kundër aktvendimit sipas paragrafit (4) të këtij neni, personi fizik mund të inicojë kontest administrativ para gjykatës kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

(6) Për fshirjen nga regjistri përaktës, personi i autorizuar zyrtar i Institutit në afat prej pesë ditëve nga miratimi i aktvendimit sipas paragrafit (4) të këtij neni sipas detyrës zyrtare e njofton Regjistrin Qendror dhe Drejtorinë e të Ardhurave Publike.

## VII. PROCEDURA DISIPLINORE

### Neni 37

(1) Procedurë disiplinore kundër kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar inicon dhe shqipton masa disiplinore Komisioni disiplinor i Institutit në përputhje me këtë ligj.

(2) Komisioni disiplinor është i përbërë nga pesë anëtarë me mandat prej dy viteve. Kryetari dhe anëtarët e Komisionit disiplinor zgjidhen nga Kuvendi i Institutit me propozim të Këshillit drejtues, prej të cilëve tre anëtarë nga radha e anëtarëve të Institutit dhe dy anëtarë janë persona profesionistë nga jashtë në sferën e së drejtës së biznesit, financave, kontabilitetit dhe revizionit.

(3) Gjatë shqiptimit të masave disiplinore merret parasysh pesha e shkeljes, pasojat e saj, shkalla e përgjegjësisë së autorit, rrethanat në të cilat është kryer shkelja, sjellja e tij e mëparshme, si dhe rrethanat e tjera lehtësuese dhe rënduese.

(4) Në rast të përsëritjes së shkeljes disiplinore në periudhë prej një deri tre viteve nga dita e shqiptimit të masës disiplinore, shqiptohet masë më e rëndë disiplinore sipas paragrafit (8) të këtij neni. Në rast të shqiptimit të masës disiplinore fshirjes nga regjistri përaktës, hiqet certifikata e kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar.

(5) Procedurë disiplinore kundër personit fizik, ushtruesit të punëve të kontabilitetit, iniciohet me kërkesë të parashtruar nga Organet e Institutit, subjekti juridik ku është punësuar dhe me kërkesë me shkrim të organit shtetëror. Procedurë disiplinore nuk iniciohet me kërkesë me shkrim të një anëtari të Komisionit disiplinor.

(6) Komisioni disiplinor obligohet në afat prej 30 ditëve nga dita e kërkesës së parashtruar sipas paragrafit (5) të këtij neni, të miratojë: 1) Aktvendim me të cilin refuzohet propozimi për inicim

të procedurës disiplinore, nëse propozimi parashtrohet nga parashtruesi i paautorizuar ose anonim. 2) Aktvendim me të cilin personi lirohet nga përgjegjësia se ka kryer shkelje disiplinore dhe 3) Aktvendim me të cilin personit konstatohet se ka kryer shkelje disiplinore dhe me të cilin shqiptohet masë përfundimtare disiplinore.

(7) Me përjashtim sipas paragrafit (6) të këtij neni, nëse nevojitet zbatimi dhe paraqitja e nj numri më të madh të provave, Komisioni disiplinor do ta miratojë aktvendimin në afat jo më të gjatë se 60 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës sipas paragrafit (5) të këtij neni.

(8) Komisioni disiplinor për shkeljen disiplinore mund të shqiptojë masë disiplinore: 1) vërejtje publike; 2) dënim financiar; 3) fshirje e përkohshme nga regjistri përkatës i Institutit dhe 4) fshirje nga regjistri përkatës i Institutit dhe heqje e certifikatës së kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar.

(9) Afati i vjetërsimit për iniciimin e procedurës disiplinore është një vit nga konstatimi i shkeljes disiplinore dhe tri vite nga dita e kryerjes së shkeljes. Vjetërsimi ndërprehet kur procedura disiplinore është në ndalesë për shkak të mungesës së kryerësit të shkeljes disiplinore. Ndërprerja e vjetërsimit ndodh në fillim të veprimit procedural të procedurës disiplinore.

(10) Anëtarëve të Komisionit disiplinor u paguhet kompensim mujor financiar në vlerë prej 20% të vlerës së pagës mesatare mujore neto të paguar në muajin dhjetor të vitit paraprak të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikave, ku kompensimi financiar vjetor nuk duhet të jetë më shumë se 20% e vlerës dyvjeçare mujore të pagës mesatare mujore neto të paguar në muajin dhjetor të vitit paraprak. Kompensimi financiar paguhet nëse mbahet mbledhje e punës së Komisionit në të cilën është miratuar aktvendimi sipas paragrafit (6) të këtij neni.

(11) Këshilli drejtues i Institutit përcakton në mënyrë të hollësishme mënyrën e punës së Komisionit disiplinor. Neni 38 Masa disiplinore - vërejtje publike i shqiptohet personit fizik, ushtruesit të punëve të kontabilitetit nëse: 1) nuk e paguan kompensimin e anëtarësisë në mënyrë të pajustificueshme në afat prej tri muajve pas përfundimit të afatit të caktuar të pagesës; 2) nuk i mban në mënyrë të duhur dhe të rregullt librat tregtare/afariste dhe dokumentacionin tjetër kontabilist të përcaktuar me ligj; Стр. 46 - Бр. 173 1 аврст 2022 3) refuzon në mënyrë të pajustificueshme që të kryejë pranim-dorëzimin e dokumentacionit të kontabilitetit pas përfundimit të marrëveshjes për punë të ushtruesi i punëve të kontabilitetit, përkatësisht marrëveshjes për kryerjen e shërbimeve të kontabilitetit të lidhur me obliguesin për kryerjen e punëve të kontabilitetit. 4) nuk merr pjesë në dy mbledhje radhazi si anëtar i Kuvendit të Institutit, Këshillit mbikëqyrës ose Këshillit drejtues pa njoftim paraprak ose me arsyetim me shkrim; 5) dëmton me sjelljen e tij reputacionin e profesionit të kontabilitetit dhe 6) refuzon ose në mënyrë të pandërgjegjshme i përmbush detyrimet e përcaktuara me Statutin dhe aktet e Institutit.

#### Neni 39

Personi fizik kontabilist, ushtrues i punëve të kontabilitetit, i cili do ta përsërisë të njëjtën shkelje për të cilën paraprakisht i është shqiptuar masë disiplinore - vërejtje publike i shqiptohet masa disiplinore në vlerë prej 30% të një page mesatare mujore neto të paguar për të punësuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për muajin në të cilin i është shqiptuar masa disiplinore.

#### Neni 40

- (1) Masa disiplinore fshirje e përkohshme nga regjistri përkatës në kohëzgjatje prej një viti i shqiptohet personit fizik, ushtruesit të punëve të kontabilitetit nëse: 1) nuk e respekton detyrimin për përsosje të vazhdueshme profesionale në përputhje me këtë ligj; 2) nuk e informon Institutin për të gjitha ndryshimet lidhur me të dhënat e përfshira në regjistrin përkatës në përputhje me këtë ligj; 3) shkakton dëm material të konsiderueshëm ndaj subjektit ku punon gjatë kryerjes së punëve të kontabilitetit; 4) kryen punët e kontabilitetit në mënyrë të pandërgjegjshme dhe joprofesionale pa respektuar rregullat dhe Kodin ndërkombëtar të etikës së kontabilistëve profesionistë. 5) nënshkruan llogari vjetore/raporte financiare dhe fletëparaqitje tatimore/bilancet për kryerjen e punëve të kontabilitetit të obliguesit me të cilin nuk ka lidhur marrëveshje për punësim me orar të plotë ose të shkurtuar të punës; 6) nënshkruan llogari vjetore dhe fletëparaqitje tatimore për obliguesin për udhëheqjen e punëve të kontabilitetit për të cilin shoqëria për udhëheqjen e punëve të kontabilitetit dhe/ose tregtari individ – kontabilist ose kontabilist i autorizuar ku është i punësuar nuk ka lidhur marrëveshje për kryerjen e punëve të kontabilitetit;
- (2) Kontabilisti, përkatësisht kontabilisti i autorizuar mund të parashtrojë kërkesë për regjistrim në regjistrin përkatës të Institutit, pas përfundimit të periudhës për të cilën është fshirë në përputhje me nenin 36 paragrafi (2) pikat 2 dhe 3 të këtij ligji.

#### Neni 41

- (1) Masa disiplinore për fshirjen nga regjistri përkaës dhe heqja e certifikatës së kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar shqiptohet nëse: 1) kryen punë të kontabilitetit gjatë kohëzgjatjes së masës për fshirje të përkohshme nga regjistri përkatës; 2) e vendos interesin personal financiar në konflikt interesi me pozitën dhe statusin e profesionit të kontabilistit; 3) shpërndan informacione të fituara gjatë kryerjes së punëve të kontabilitetit, përkatësisht me ato vepron me to në kundërshtim me nenin 24 paragrafi (2) të këtij ligji; 4) përsërit shkeljen sipas nenit 40 paragrafi (1) pika 5) e këtij ligji; 5) refuzon që t'u ofrojë të dhëna organeve shtetërore, personave juridikë dhe qytetarëve, nëse dhënia e tyre është përcaktuar me ligj dhe 6) ofron të dhëna të pasakta ndaj organeve shtetërore, personave juridikë dhe qytetarëve, nëse dhënia e të dhënave është përcaktuar me ligj dhe
- (2) Kontabilisti, përaktësisht kontabilisti i autorizuar mund të parashtrojë kërkesë për dhënie e provimit për të fituar statutin e kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar, pas përfundimit të dy viteve nga dita e fshirjes nga regjistri përkatës.

#### Neni 42

Përgjegjësia për veprën e kryer penale, përkatësisht kundërvajtja e procesuar nga institucionet kompetente, nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të personit fizik, ushtruesit të punëve të kontabilitetit.

#### Neni 43

Kundër aktvendimit të Komisionit disiplinor me të cilin shqiptohet masë disiplinore, mund të ngrihet kontest administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

#### Neni 44

(1) Kryetari i Institutit e zbaton aktvendimin e miratuar në procedurë disiplinore. Aktvendimi evidentohet në regjistrin përkatës të Institutit dhe në afat prej 48 orëve publikohet në faqen e internetit të Institutit.

(2) Masa disiplinore sipas nenit 37 paragrafi (8) pika 1) të këtij ligji fshihet nga regjistri përkatës i Institutit pasi që të kalojë një vit nga regjistrimi i saj.

(3) Masa disiplinore sipas nenit 37 paragrafi (8) pika 2) të këtij ligji fshihet nga regjistri përkatës i Institutit pasi që të kalojë një vit nga regjistrimi i saj.

(4) Masa disiplinore sipas nenit 37 paragrafi (8) pika 3) të këtij ligji fshihet nga regjistri përkatës i Institutit pasi që të kalojë një vit nga regjistrimi i saj.

### VIII. KONTROLLI I CILËSISË SË PUNËS

#### Neni 45

(1) Institutit kryen kontroll të cilësisë së punës së tregtarit individ – kontabilist, tregtarit individ-kontabilist të autorizuar dhe shoqërisë për kryerjen e punëve të kontabilitetit (në tekstin e mëtejshëm: subjekte të kontrollit), për shkak të vlerësimit të dokumentuar të punës së tyre në mënyrë të duhur dhe të ligjshme.

(2) Kontrolli i cilësisë së subjekteve të kontrollit kryhet në bazë të Rregullores, që miratohet nga Këshilli drejtues i Institutit, me të cilën përcaktohet mënyra dhe procedurat për kryerjen e kontrollit të subjekteve të kontrollit.

(3) Kontrollin sipas paragrafit (1) të këtij neni e kryejnë kontabilistët gjegjësisht kontabilistët e autorizuar të punësuar në shërbimin profesional të Institutit (në tekstin e mëtejshëm: kontrollorë) të cilët kanë: 1) statusin e kontabilistit ose kontabilistit të autorizuar dhe janë të regjistruar në regjistrat përkatës të Institutit dhe 2) kanë të paktën pesë vjet përvojë pune të pandërprerë në kryerjen e punëve të kontabilitetit.

(4) Institutit nuk mund të caktojë kontrollor te subjekti i kontrollit, një person që të paktën tri vite para fillimit të kontrollit ka qenë pronar ose i punësuar te subjekti i kontrollit.

(5) Para fillimit të kontrollit, kontrollori duhet të japë deklaratë me shkrim, se sa i përket subjektit të kontrollit posedon integritet sipas paragrafit (4) të këtij neni.

#### Neni 46

(1) Kontrolli i cilësisë së punës së subjekteve të kontrollit përfshin verifikimin dhe vlerësimin e: 1) plotësisimit të kërkesave të Kodit ndërkombëtar të etikës për kontabilistët profesionistë të IFAC, akteve të Institutit dhe të këtij ligji, 2) plotësisimit të kërkesave për pavarësi në lidhje me obliguesin për kryerjen e kontabilitetit, 3) kuantitetit dhe cilësisë së burimeve njerëzore të angazhuara, 4) plotësisimit të kushteve për posedimin e licencës për kryerjen e punëve të



kontabilitetit, 1 абрuct 2022 Бр. 173 - Стр. 47 5) plotësimin të kushteve të të punësuarve për regjistrim në regjistrin përkatës të Institutit dhe 6) përputhshmërisë së politikave dhe procedurave të sistemit të kontrolleve të brendshme të punës.

(2) Kontrolli i cilësisë së subjekteve të kontrollit kryhet nëpërmjet: 1) kontrollit jashtë terrenit dhe 2) kontrollit në terren.

(3) Kontrolli jashtë terrenit zbatohet si kontroll i rregullt të të gjitha subjektet e kontrollit, detyrimisht një herë në vit nëpërmjet mbledhjes, përpunimit dhe analizimit të pyetësorit vjetor të kontrollit që Instituti ua dorëzon në mënyrë elektronike subjekteve të kontrollit më së voni deri më datë 20 dhjetor të vitit rrjedhës. Subjektet e kontrollit detyrohen që pyetësin e plotësuar të kontrollit ta dorëzojnë në Institut më së voni deri më datë 31 mars të vitit rrjedhës, që i referohet vitit paraprak.

(4) Në rast të konstatimit të parregullsive apo paligjshmërive gjatë punës të subjektet e kontrollit, mund të kryhet kontroll shtesë jashtë terrenit në bazë të pyetësorit shtesë, që u dorëzohet në mënyrë elektronike subjekteve të kontrollit.

(5) Nëse me kontrollin jashtë terrenit konstatohen parregullsi apo paligjshmëri serioze, mund të kryhet kontroll në terren dhe/ose të shqiptohen masa kontrolli në përputhje me nenin 47 të këtij ligji.

(6) Kontrolli në terren të të gjitha subjektet e kontrollit kryhet të paktën një herë në pesë vite.

(7) Në përjashtim të dispozitave të paragrafit (5) të këtij neni, periudha ndërmjet dy kontrolleve në terren mund të jetë edhe më e shkurtër nëse me kontrollin paraprak në terren cilësia e punës është vlerësuar si e pakënaqshme ose kur kontrolli i drejtpërdrejtë në terren kryhet me kërkesë të klientit të subjektit të kontrollit ose një pale tjetër të interesuar.

(8) Kontrolli i cilësisë së punës së subjekteve të kontrollit kryhet sipas programit vjetor të miratuar nga Këshilli drejtues i Institutit, që posaçërisht përmban numrin e subjekteve të kontrollit që do të përfshihen në kontrollin dhe në orarin e kontrolleve të planifikuara për terren. Programi i referohet periudhës njëvjeçare, që është e ndryshme nga viti kalendarik.

(9) Kontrolli në terren kryhet për të kontrolluar punën ligjore dhe të rregullt. Përcaktimi i fushëveprimit të kontrollit në terren kryhet në bazë të numrit dhe strukturës së të punësuarve, përqindjes së përfaqësuar të klientëve sipas madhësisë dhe formës së organizimit, natyrës, llojit, fushëveprimit dhe ndërlikueshmërisë së qasjes dhe mënyrave të kryerjes së punëve të kontabilitetit që i kryen subjekti i kontrollit.

(10) Kontrollori përpilon raport për kontrollin e kryer në terren në të cilin i shënon parregullsitë dhe/ose paligjshmëritë e konstatuara, afatin për mënjanimin e tyre dhe propozon masa kontrolli në përputhje me nenin 47 paragrafi (1) të këtij ligji.

(11) Raporti sipas paragrafit (9) të këtij neni i dorëzohet Këshillit drejtues dhe subjektit të kontrollit që ka të drejtë për ankimim në afat prej tetë ditëve të punës nga dita e marrjes së ankimit të Raportit. Këshilli drejtues vendos lidhur me ankimimin në afat prej shtatë ditëve të punës nga dita e pranimit.

(12) Subjekti i kontrollit detyrohet që në afatin e përcaktuar në raportin sipas paragrafit (10) të këtij neni t'i mënjanojë parregullsitë dhe paligjshmëritë e konstatuara dhe në Institut të dorëzojë raport në të cilin do t'i përshkruajë masat e ndërmarra dhe do t'i bashkëngjisë dokumentet dhe dëshmitë për mënjanimin e parregullsive dhe paligjshmërive.

#### Neni 47

(1) Masat e kontrollit për subjektet e kontrollit mund të jenë: 1) paraqitja e nevojës për punë dhe detyrime që kontribuojnë në vendosjen e ligjshmërisë dhe harmonizimit të punës me këtë ligj, 2) miratimi dhe zbatimi i planit aksional për politikatat dhe procedurat interne që rregullojnë punën dhe monitorimin e sistemit të kontroleve të brendshme, 3) miratimi dhe zbatimi i akteve interne - politikatat dhe procedurat për veprim dhe monitorim mbi punën me të dhënat kofidenciale

(2) Në bazë të raportit të kontrollit të zbatuar sipas nenit 46 të këtij ligji, Këshilli drejtues i Institutit mund të ngrejë procedurë kundërvajtëse në gjykatën kompetente.

## IX. MBIKËQYRJA

### Neni 48

Ministria e Financave e kryen mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

### Neni 49

(1) Mbikëqyrje mbi punën e Institutit kryen Këshilli.

(2) Mbikëqyrja sipas paragrafit (1) të këtij neni përfshin mbikëqyrjen e punës ligjore dhe të rregullt të Institutit në përputhje me këtë ligj. Në rast të aprovimit, gjegjësisht të miratimit të aktit të Institutit në kundërshtim me këtë ligj, kryetari i këshillit ngre procedurë për shfuqizimin e tij para Kuvendit të Institutit.

(3) Kryetari i Institutit detyrohet që gjatë mbikëqyrjes sipas paragrafit (1) të këtij neni të sigurojë qasje të pakufizuar në hapësirat, mjetet dhe të gjitha informacionet dhe dokumentet që janë relevante për mbikëqyrjen dhe të sigurojë kushtet e nevojshme për punën e pandërprerë të tij. Kryetari i Institutit detyrohet të jetë i pranishëm gjatë mbikëqyrjes, ndërsa në rast të pamundësisë zëvendësohet nga anëtari i Këshillit drejtues ose kryetari i Këshillit mbikëqyrës ose nga anëtari i Këshillit mbikëqyrës.

(4) Për mbikëqyrjen e realizuar përpilohet procesverbal me udhëzime dhe afat për mënjanimin e parregullsive dhe paligjshmërive të konstatuara. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet Institutit në afat prej 15 ditëve nga dita e mbikëqyrjes së realizuar. Pas pranimit të procesverbalit, Instituti ka të drejtë të paraqesë ankimim në Këshill në afat prej pesë ditëve.

(5) Në bazë të parregullsive dhe/ose paligjshmërive të konstatuara nga mbikëqyrja e përcaktuar në procesverbalin sipas paragrafit (4) të këtij neni, Këshilli mund të miratojë aktvendim me të cilin: 1) e detyron kryetarin e Institutit, Këshillin drejtues dhe Këshillin mbikëqyrës që t'i mënjanojë parregullsitë dhe paligjshmëritë e konstatuara në procesverbal dhe/ose 2) konstaton pavlefshmërinë e aktit të miratuar në kundërshtim me këtë ligj dhe/ose 3) e detyron Kuvendin e Institutit që ta shkarkojë kryetarin e Institutit dhe/ose anëtarët e Këshillit drejtues dhe/ose anëtarët e Këshillit mbikëqyrës së Institutit, nëse Instituti miraton akt në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe në kundërshtim me interesat e anëtarëve të Institutit/ose nuk i realizon detyrimet e përcaktuara me këtë ligj dhe Statutin e Institutit dhe/ose nuk vepron sipas udhëzimeve të dhëna në procesverbalin sipas paragrafit (4) të këtij neni.

(6) Në aktvendimin sipas paragrafit (5) të këtij neni, Këshilli do të caktojë afat për përzgjedhjen e anëtarëve të rinj të Këshillit drejtues, Këshillit mbikëqyrës të Institutit dhe/ose kryetarit të Institutit që nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë nga dita e dorëzimit të aktvendimit dhe do të emërojë më së shumti tre anëtarë të Institutit, të cilët do të kryejnë kompetencat e anëtarëve të Këshillit drejtues, Këshillit mbikëqyrës së Institutit dhe/ose kryetarit të Institutit deri në përzgjedhjen e tyre në procedurat e zbatuara sipas këtij ligji në afat prej 45 ditëve.

(7) Përzgjedhja sipas paragrafit (6) të këtij neni kryhet në përputhje me kushtet dhe procedurën e përcaktuar me këtë ligj. (8) Nëse gjatë mbikëqyrjes mbi punën e Institutit konstatohet se ka shkelje të këtij ligji, Këshilli do t'i njoftojë organet kompetente për ngritjen e procedurës penale dhe/ose kundërvajtëse. Стр. 48 - Бр. 173 1 август 2022

#### X. DISPOZITA KUNDERVAJTËSE

##### Neni 50

(1) Gjobë me vlerë prej 100 deri në 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik, nëse kryen punë të kontabilitetit, ndërsa nuk i plotëson kushtet e nenit 25 të këtij ligji.

(2) Krahas gjobës për veprimin sipas paragrafit (1) të këtij neni personit fizik do t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje për ndalimin e kryerjes së profesionit, veprimtarisë me kohëzgjatje prej një viti.

(3) Gjobë me vlerë prej 100 deri në 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit individ nëse kryen punë të kontabilitetit, ndërsa nuk i plotëson kushtet e nenit 32 paragrafi (2) të këtij ligji.

(4) Krahas gjobës për veprimin sipas paragrafit (3) të këtij neni personit fizik do t'i shqiptohet sanksion për kundërvajtje për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë me kohëzgjatje prej një viti.

##### Neni 51

Gjobë me vlerë prej 100 deri në 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje kontabilistit, gjegjësisht kontabilistit të autorizuar, nëse:

1) përpilon dhe nënshkruan llogari vjetore dhe/ose raporte financiare në kundërshtim me nenin 31 paragrafi (2) gjegjësisht me paragrafin (3) të këtij ligji, 2) nënshkruan llogari vjetore dhe fletëparaqitje tatimore në kundërshtim me nenin 31 paragrafi (7) të këtij ligji dhe 3) nuk e njofton Institutin sipas nenit 35 paragrafi (6) të këtij ligji.

##### Neni 52

(1) Gjobë me vlerë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë denari për shoqërinë që kryen punë të kontabilitetit për tregtar mikro, nga 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë denari për shoqërinë që kryen punë të kontabilitetit për tregtar të vogël, nga 1.500 deri në 2.500 euro në kundërvlerë denari për shoqërinë që kryen punë të kontabilitetit për tregtar të mesëm dhe nga

2.000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë denari për shoqërinë që kryen punë të kontabilitetit për tregtar të madh do t'i shqiptohet kundërvajtje personit juridik nëse: 1) nuk lidh marrëveshje me obliguesin për udhëheqjen e kontabilitetit në përputhje me nenin 31 paragrafi (11) të këtij ligji; 2) kryerjen e punëve të kontabilitetit ia transferon pronarit tjetër individ, përkatësisht shoqërisë për kryerjen e punëve të kontabilitetit pa pëlqimin me shkrim të obliguesit për udhëheqjen e kontabilitetit (neni 31 paragrafi (13)), 3) nuk kryen regjistrim të licencës për punë në Regjistrin Qendror në përputhje me nenin 32 paragrafi (8) të këtij ligji. 4) nuk e njofton Institutin se janë mënjanuar dhe/ose nuk i mënjanon parregullsitë dhe paligjshmëritë dhe nuk dorëzon Raport në përputhje me nenin 46 paragrafi (12) të këtij ligji.

(2) Gjobë me vlerë prej 100 deri në 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet tregtarit individ - kontabilist, tregtarit individ - kontabilist i autorizuar për kundërvajtjet sipas nenit (1) të këtij ligji.

(3) Për kundërvajtjet sipas paragrafit (1) të këtij neni, gjoba me vlerë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit përgjegjës në shoqëri sipas paragrafit (1) të këtij neni.

#### Neni 53

(1) Gjobë me vlerë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje Institutit, nëse: 1) nuk i përkthen dhe përditëson SNRF dhe МФСИ për NVM në përputhje me nenin 16 paragrafi (1) pika 13 të këtij ligji, 2) nuk i miraton aktet sipas nenit 17 paragrafi (12) pikat 15) dhe 16) të këtij ligji; 3) nuk i publikon aktet e Kuvendit të Institutit sipas nenit 17 paragrafi (16) të këtij ligji; 4) vlerën e kompensimit e përcakton në kundërshtim me nenin 17 paragrafi (14) të këtij ligji, 5) nuk lëshon certifikatë në përputhje me nenin 26 paragrafi (5), nenin 29 paragrafi (3) dhe nenin 33 paragrafi (2) të këtij ligji, 6) nuk kryen regjistrim në regjistrin përkatës në përputhje me nenin 27 paragrafi (7) të këtij ligji, 7) nuk lëshon licencë dhe nuk kryen regjistrim në regjistrin përkatës në afatin sipas nenit 32 paragrafi (6) të këtij ligji; 8) nuk i publikon në faqen e internetit të gjitha aktet, vendimet, vërejtjet e miratuara, në përputhje me nenin 20 paragrafi (7) dhe nenin 44 paragrafi (1) të këtij ligji dhe 9) nuk i mënjanon parregullsitë ose/dhe paligjshmëritë e përcaktuara në përputhje me nenin 49 paragrafi (5) pika 1 të këtij ligji. (2) Gjobë me vlerë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet edhe kryetarit të Institutit për kundërvajtjet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

#### Neni 54

(1) Gjobë me vlerë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit zyrtar të autorizuar në Institut nëse në afatin e përcaktuar në nenin 27 paragrafi (5) dhe nenin 32 paragrafi (3) të këtij ligji nuk i kërkon dokumentet e nevojshme.

(2) Gjobë me vlerë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit zyrtar të autorizuar në Regjistrin Qendror nëse në afatin e përcaktuar në nenin 27 paragrafi (6) dhe nenin 32 paragrafi (4) të këtij ligji nuk i dorëzon dokumentet që kërkohen.

(3) Gjobë me vlerë prej 25 deri në 50 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit zyrtar të autorizuar në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nëse në afatin e përcaktuar në nenin 27 paragrafi (6) të këtij ligji nuk i dorëzon dokumentet që kërkohen.

(4) Gjobë me vlerë prej 50 deri në 100 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit nëse nuk e njofton Institutin për ndryshimet që kanë ndodhur sipas nenit 35 paragrafi (6) të këtij ligji.

#### Neni 55

Gjobë me vlerë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje kryetarit të Institutit, nëse në përputhje me këtë ligj: 1) nuk e thërret mbledhje të Kuvendit të Institutit në afatin sipas nenit 18 paragrafi (7) të këtij ligji; 2) nuk i publikon vendimet e Këshillit drejtues në afatin në nenin 20 paragrafi (7) të këtij ligji dhe 3) gjatë mbikëqyrjes nuk vepron në përputhje me nenin 49 paragrafi (3) të këtij ligji.

#### Neni 56

Gjobë me vlerë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve të Këshillit drejtues së Institutit, nëse: 1) nuk miratojnë vendim për thirrjen e seancës së Kuvendit të Instituti në afatin dhe në procedurën e përcaktuar në nenin 18 paragrafi (7) të këtij ligji dhe 2) nuk dorëzon raport në përputhje me nenin 20 paragrafi (8) të këtij ligji.

#### Neni 57

Gjobë me vlerë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës së Institutit, nëse nuk veprojnë në përputhje me neni 19 paragrafi (6) pikat 10 dhe 11 të këtij ligji.

#### Neni 58

Gjobë me vlerë prej 100 deri në 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje anëtarit të organit ose Komisionit të Institutit dhe të punësuarit në shërbimin profesional të Institutit nëse vepron në kundërshtim me këtë ligj. 1 абрyct 2022 Бр. 173 - Стр. 49

#### Neni 59

Për kundervajtjet e përcaktuara me këtë ligj, procedurën për kundervajtje e udhëheq si dhe sanksionet për kundërvajtje i shqipton gjykata kompetente.

#### Neni 60

Vlerësimi i vlerës së gjobës kryhet në përputhje me Ligjin e Kundërvajtjes.

### XI. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

#### Neni 61

(1) Instituti i themeluar në përputhje me dispozitat e Ligjit të Kryerjes së Punëve të Kontabilitetit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 95/12, 188/13, 27/14, 154/15, 192/15, 23/ 16, 190/16 dhe 193/17), me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, vazhdon me punë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(2) Certifikatat për kontabilist, gjegjësisht kontabilist të autorizuar të lëshuara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe të evidentuara në regjistrin e kontabilistëve, përkatësisht në regjistrin e kontabilistëve të autorizuar, vazhdojnë të jenë të vlefshme si certifikata të lëshuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Licencat për punë të tregtarëve individë - kontabilistë, tregtarëve individë - kontabilistë të autorizuar dhe shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilitetit të lëshuara nga Instituti deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe të evidentuara në regjistrin e tregtarëve individë - kontabilistë, regjistrin e tregtarëve individë - kontabilistë të autorizuar dhe regjistrin e shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilistëve vazhdojnë të jenë të vlefshme si licenca të lëshuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

#### Neni 62

Procedurat e filluara për marrjen e statusit të kontabilistit, përkatësisht kontabilistit të autorizuar, procedurat e filluara për marrjen e licencës së punës për tregtar individ - kontabilist, tregtar individ kontabilist të autorizuar dhe shoqëri për kryerjen e punëve të kontabilitetit dhe procedurat e filluara disiplinore deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë në përputhje me Ligjin e Kryerjes së Punëve të Kontabilitetit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 95/12, 188/13, 27/14, 154/15, 192/15, 23/16, 190/16 dhe 193/17).

#### Neni 63

(1) Instituti detyrohet që në afat prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e rregullores sipas nenit 35 paragrafi (8) të këtij ligji ta harmonizojë përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të kontabilistëve, regjistrin të kontabilistëve të autorizuar, regjistrin të tregtarëve individë - kontabilistë, regjistrin të tregtarëve individë - kontabilistë të autorizuar dhe regjistrin të shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilitetit me dispozitat e këtij ligji.

(2) Kontabilistët dhe kontabilistët e autorizuar që janë të evidentuar në regjistrin e kontabilistëve dhe në Regjistrin e kontabilistëve të autorizuar detyrohen që në afat prej 60 ditëve nga përfundimi i afatit sipas paragrafit (1) të këtij neni t'i përditësojnë të dhënat në regjistrin përkatës të Institutit në përputhje me nenin 35, paragrafi (3) të këtij ligji.

(3) Tregtarët individë - kontabilistë, tregtarët individë - kontabilistë të autorizuar dhe shoqëritë për kryerjen e punëve të kontabilitetit që janë të evidentuar në regjistrin e tregtarëve individë - kontabilistë, në regjistrin e tregtarëve individë - kontabilistë të autorizuar dhe në regjistrin e shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilitetit 60 ditë nga dita e përfundimit të afatit sipas paragrafit (1) të këtij neni detyrohen t'i përditësojnë të dhënat në regjistrin përkatës në përputhje me nenin 35 paragrafi (4) të këtij ligji.

(4) Tregtarëve individë - kontabilistë, tregtarëve individë - kontabilistë të autorizuar dhe shoqërive për kryerjen e punëve të kontabilitetit të cilëve u janë lëshuar licenca për kryerjen e punëve të kontabilitetit në përputhje me dispozitat e Ligjit e Kryerjes së Punëve të Kontabilitetit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 95/ 12, 188/13, 27/14, 154/15, 192/15, 23/16, 190/16 dhe 193/17) dhe që deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të dhënat mbi lëshimin e licencës së punës nuk e kanë evidentuar në Regjistrin Qendror detyrohen që të kryejnë evidencë të të dhënave për lëshimin e licencës në Regjistrin Qendror në afat prej 60 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

#### Neni 64

(1) Kontabilist, përkatësisht kontabilist i autorizuar i cili ka filluar të ndjek orët për përsosje të vazhdueshme profesionale në vitin kalendarik 2017 dhe 2018, dhe i cili për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur me koronavirus, në pajtim me Dekretin me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për kryerje të punëve të kontabilitetit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut numër 140/20), nuk kanë mund ta plotësojnë ciklin e parë trevjeçar të orëve deri më 31 dhjetor 2021, kanë mundësi t'i plotësojnë orët deri më 31 dhjetor 2024.

(2) Kontabilisti, përkatësisht kontabilist i autorizuar i cili ka filluar të ndjek orët për përsosje të vazhdueshme profesionale në vitin kalendarik 2017 dhe 2018 është i obliguar, përveç plotësimit të orëve nga cikli i parë i trajnimeve sipas paragrafit (1) të këtij neni, t'i plotësojë edhe orët nga cikli i dytë i trajnimeve sipas paragrafit (6) të këtij neni deri në fund të 31 dhjetor 2024 me ndjekje të 40 orëve për kontabilist dhe 60 orëve për kontabilist të autorizuar.

(3) Kontabilisti, përkatësisht kontabilist i autorizuar i cili ka filluar t'i ndjek orët për përsosje të vazhdueshme profesionale në vitin 2019, 2020 dhe 2021 është i obliguar deri në fillimin e ciklit të tretë të trajnimit sipas paragrafit (7) të këtij neni, t'i plotësojë 40 orë për kontabilist, përkatësisht 60 orë për kontabilist të autorizuar.

(4) Kontabilisti, përkatësisht kontabilist i autorizuar i cili do të fillojë t'i ndjek orët për përsosje të vazhdueshme profesionale në vitin 2022 është i detyruar deri në fillimin e ciklit të tretë të trajnimit sipas paragrafit (7) të këtij neni, t'i plotësojë 40 orë për kontabilist, përkatësisht 60 orë për kontabilist të autorizuar.

(5) Kontabilisti, përkatësisht kontabilist i autorizuar i cili do të fillojë të ndjek orët për përsosje të vazhdueshme profesionale në vitin 2023 është i obliguar që deri në fillimin e ciklit të tretë të trajnimit sipas paragrafit (7) të këtij neni t'i plotësojë 20 orë për kontabilist ose 30 orë për kontabilist të autorizuar.

(6) Cikli i dytë i trajnimeve për përsosje të vazhdueshme profesionale fillon më 1 janar 2022 dhe përfundon më 31 dhjetor 2024.

(7) Cikli i tretë i trajnimeve fillon më 1 janar 2025 me zbatimin e dispozitave sipas nenit 30, paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

#### Neni 65

Provimi i parë për marrjen e statusit kontabilist, gjegjësisht kontabilist i autorizuar në përputhje me këtë ligj do të fillojë të mbahet në afat prej tre viteve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### Neni 66

Deri sa të fillojë mbajtja e provimit të parë për marrjen e statusit kontabilist gjegjësisht kontabilist të autorizuar, certifikatat për kontabilist ose kontabilist të autorizuar do të lëshohen sipas kushteve dhe mënyrës në përputhje me Ligjin e Kryerjes së Punëve të Kontabilitetit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 95/12, 188/13, 27/14, 154/15, 192/15, 23/16, 190/16 dhe 193/17).

#### Neni 67

Regjistri i personave juridikë që kryejnë trajnime për përsosje të vazhdueshme profesionale do të themelohet në afat prej nëntë muajve nga hyrja në fuqi e rregullores sipas nenit 35 paragrafi (8) të këtij ligji. Стр. 50 - Бр. 173 1 август 2022

#### Neni 68

Regjistri i kontabilistëve praktikantë do të krijohet në afat prej tre muajve nga hyrja në fuqi e rregullores sipas nenit 35 paragrafi (8) të këtij ligji. Neni 69 Instituti do të përkthejë SNRF dhe SNRF për NVM në afat prej 12 muajve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

#### Neni 70

Instituti detyrohet që të dhënat për kontabilistët, gjegjësisht kontabilistët e autorizuar nga Regjistri i kontabilistëve dhe Regjistri i kontabilistëve të autorizuar t'i dorëzojë në Regjistrin Qendror në afat prej 90 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

#### Neni 71

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në afat prej 15 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji do të themelojë Këshillin për avancim dhe mbikëqyrje të profesionit të kontabilitetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Deri sa të mbahet mbledhja konstituive e Kuvendit të Institutit sipas nenit 73 paragrafi

(3) të këtij ligji, në vend që anëtari ta propozojë Kuvendin e Institutit, atë do ta propozojë së bashku Oda Ekonomike e Maqedonisë së Veriut, Lidhja e Odave Ekonomike të Maqedonisë dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore, me mandat deri në nëntë muaj nga dita e themelimit të Këshillit.

#### Neni 72

(1) Deri sa të përzgjedhet kryetari i ri i Institutit dhe anëtarët e rinj të Kuvendit, Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës së Institutit, Këshilli përzgjedh ushtruesin e detyrës së kryetarit të Institutit.



- (2) Përzgjedhja e ushtruesit të detyrës sipas paragrafit (1) të këtij neni realizohet me shpallje publike në afat prej 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.
- (3) Këshilli themelon Komision për përzgjedhjen e ushtruesit të detyrës sipas nenit (1) të këtij ligji në afat prej dhjetë ditëve që nga dita e fillimit të punës së tij.
- (4) Komisioni për përzgjedhjen e ushtruesit të detyrës së kryetarit të Institutit përbëhet nga pesë anëtarë, prej të cilëve: 1) katër janë kontabilistë të autorizuar me së paku me pesë vjet përvojë pune në kryerjen e punëve të kontabilitetit të propozuar nga odat ekonomike dhe 2) një është profesor universitar në sferën e kontabilitetit dhe revizionit.
- (5) Komisioni sipas paragrafit (3) të këtij neni në afat prej pesë ditëve nga dita e përzgjedhjes së tij publikon shpallje publike për përzgjedhje të ushtruesit të detyrës së kryetarit të Institutit.
- (6) Ushtruesi i detyrës së kryetarit të Institutit posaçërisht i kryen punët në vijim: 1) e prezanton dhe përfaqëson Institutin, 2) kujdeset që Instituti të punojë në përputhje me ligjin, 3) nënshkruan urdhëresat për pagesë nga llogaria e Institutit, 4) kryen punët sipas nenit 20 paragrafi (3) pikat 7), 13) dhe 17) të këtij ligji, 5) kryen punët në lidhje me organizimin e përsosjes së vazhdueshme profesionale, 6) i përgatit aktet e Institutit sipas nenit 73 paragrafi (3) të këtij ligji dhe 7) publikon raport mbi punën e tij në çdo tre muaj në faqen e internetit të Institutit.
- (7) Ushtruesi i detyrës ka të drejtë për kompensim mujor me vlerë prej së paku dy pagave mesatare neto të paguara për të punësuar në muajin dhjetor të vitit paraprak të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikave.

#### Neni 73

- (1) Punët lidhur me përpilimin dhe propozimin e akteve të Institutit sipas paragrafit (3) të këtij neni dhe përzgjedhjen e kryetarit të Institutit, anëtarëve të Kuvendit, Këshillit mbikëqyrës, Këshillit drejtues së Institutit i kryen Komisioni sipas nenit 72 paragrafi (3) të këtij ligji dhe ushtruesi i detyrës së kryetarit të Institutit. (2) Përzgjedhja e kryetarit të Institutit, anëtarëve të Kuvendit, Këshillit mbikëqyrës, Këshillit drejtues së Institutit realizohet nëpërmjet shpalljes publike ku përcaktohen kushtet për përzgjedhjen e anëtarëve të organeve të Institutit. Përzgjedhja do të zbatohet në afat prej gjashtë muajve nga dita e përzgjedhjes së Komisionit sipas nenit 72 paragrafi (3) të këtij ligji. Votimi për përzgjedhje bëhet nëpërmjet sistemit elektronik të Institutit, kurse si kryetar i përzgjedhur i Institutit, përkatësisht anëtar i Këshillit mbikëqyrës, konsiderohet kandidati me numrin më të madh të votave të fituara në listën përkatëse të kandidatëve. (3) Seanca konstituive e Kuvendit të Institutit ku do të miratohen aktet e Institutit të propozuara nga Komisioni sipas nenit 72 paragrafi (3) të këtij ligji dhe do të përzgjidhen anëtarët e Kuvendit të Institutit, Këshilli mbikëqyrës, Këshilli drejtues dhe komisionet sipas nenit 15 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji do të mbahet në afat prej gjashtë muajve nga dita e themelimit të Komisionit sipas nenit 72 paragrafi (3) të këtij ligji. Seancën e Kuvendit e thërret ushtruesi i detyrës së kryetarit të Institutit. (4) Anëtarët e Komisionit sipas nenit 72 paragrafi (3) të këtij ligji, përveç ushtruesit të detyrës së kryetarit, kanë të drejtë për kompensim financiar për punën e tyre në komision me vlerë të një page mesatare mujore neto të paguar për të punësuar në muajin dhjetor të vitit paraprak të publikuar nga Enti Shtetëror i Statistikës.

#### Neni 74

Neni 33 të këtij ligji do të fillojë të zbatohet që nga dita e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian.

#### Neni 75

Aktet nënligjore të parashikuara me këtë ligj do të miratohen në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji.

#### Neni 76

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji i Kryerjes së Punëve të Kontabilitetit. (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 95/12, 188/13, 27/14, 154/15, 192/15, 23/ 16, 190/16 dhe 193/17).

#### Neni 77

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga publikimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

## 2.Pasqyrë e të dhënave individuale për muajin KORRIK të vitit 2022

-Për sektorin privat, buxhetor dhe sektorin publik

Të dhëna nga Enti shtetëror i statistikës

### ***Paga mesatare të paguara në RMV***

1. Paga mesatare neto e paguar për punonjës në RMV në tre muajt paraprakë (mars,prill dhe maj 2022) : 31.337

2. Paga mujore mesatare neto e paguar për punonjës për muajin **maj 2022: 31.407**  
(Njoftim nga Enti shtetëror i statistikës nr. 4.1.22.66 i datës 22.07.2022)
3. Paga mujore mesatare neto e paguar për punonjës për të gjithë vitin 2021: **28.718**  
(Njoftim nga Enti shtetëror i statistikës nr. 4.1.21.16 i datës 22.02.2022)

Në pajtueshmëri me kontratën e përgjithshme kolektive për sektorin privat nga fusha e ekonomisë ("Gazeta zyrtare e RMV" nr. 88/09...150/16) paga mesatare neto e paguar për punonjës në RM në tre muajt e fundit, përdoret si bazë gjatë përlllogaritjes shpenzimeve të veçanta:

- për kompensimin e fillimit të marrjes së pensionit të paktën shumë e dyfishtë e pagës bazë;
  - për kompensimin e mëditjeve për udhëtimet zyrtare brenda vendit në shumën prej **8% të pagës bazë**
  - ndihmë në rast të vdekjes së një punëtori – **në lartësinë e tre pagave bazë;**
  - ndihmë në rast të vdekjes së një anëtari të familjes së punonjësit – **në lartësinë e 2 pagave bazë;**
  - ndihmë gjatë pasojave të rënda nga katastrofa natyrore – **në lartësinë e një page bazë;**
  - shpërblim përvjetori – **në lartësinë e pagës bazë;**
  - për jetë të ndarë nga familja në një shumë të përcaktuar me kontratën kolektive në nivelin e aktivitetit, respektivisht në nivel të punëdhënësit por jo më pak se **60% të pagës bazë;**
  - regres për pushim vjetor për minimumi 6 muaj punë në vit tek i njëjti punëdhënës **40% të pagës bazë.**
4. Paga mesatare bruto e paguar për punonjës në RMV në tre muajt paraprakë (**mar,prill dhe maj**): **46.830**
  5. Paga mujore mesatare bruto e paguar për punonjës në RMV në muajin **maj** të vitit 2022: **46.972**  
(Njoftim nga Enti shtetëror i statistikës nr. 4.1.22.67 i datës 22.07.2022.)
  6. Paga mujore mesatare bruto e paguar për punonjës për të gjithë vitin 2021- **42.887**  
(Njoftim nga Enti shtetëror i statistikës nr. 4.1.21.17 i datës 22.02.2022 .)

### **PAGA BAZË MË E ULËT PËR LLOGARITJE TË KONTRIBUTEVE NË VITIN 2022**

Paga bazë më e ulët mujore për llogaritje të kontributit për sigurimin e detyrueshëm dhe plotësues shëndetësor, SPI dhe punësim për muajin korrik 2022 është  $43.509 \times 50\% = 21.755,00$  den.

### ZVOGLIMI I TATIMIT PERSONAL PËR TË ARDHURAT PERSONALE NË VITIN 2022

1.Zvoglimi i tatimit personal për të ardhurat personale e vërtetuar në nenin 10 paragrafi 2 nga Ligji për tatime për të ardhurat personale,për vitin 2022 në nivel vjetor ,është **105.456** den.

2.Zvoglimi i tatimit personal në bazë të të ardhurave personale nga paga e marrdhënjes së punës dhe penzionit,në bazë mujore percaktohet në vlerë prej **8.788** den

### PAGA MINIMALE NË RMV PËR MUAJIN QËRSHOR TË VITIT 2022

Në pajtueshmëri me Publikimin e Ministrisë së punës dhe politikës sociale (“Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 80/21), paga minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut për muajt janar – shkurt 2022 është:

- paga bruto **22.146** den.
- tatim mbi të ardhurat personale **716** den.
- kontribute **6.201** den.
- paga neto **15.229** den.

Në pajtueshmëri me Publikimin e Ministrisë së punës dhe politikës sociale (“Gazeta zyrtare e RMV “ nr. 41/22), paga minimale në Republikën e Maqedonisë së Veriut për muajin korrik 2022 është:

- paga bruto **26.422** den.
- tatim mbi të ardhurat personale **1.024** den.
- Kontribute **7.398** den.
- paga neto **18.000** den.

### PAGA BAZË MË E LARTË PËR LLOGARITJE TË KONTRIBUTEVE NË VITIN 2022.

Në pajtueshmëri me ndryshimet e nenit 16 nga Ligji për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 171/17), duke filluar nga muaji shkurt i vitit 2018. U aplikua baza më e lartë për kontribute prej:

- 16 për qind paga bruto  
Për pagë **696.144**  
(43.509 x 16 = 696.144)
- 16 për qind paga bruto për  
Administratorë, anëtarë të bordeve drejtuese dhe anëtarë ekzekutivë të bordit të drejtorëve në shoqëri tregtare  
(43.509 x 16 = 696.144) **696.144**
- 12 për qind paga bruto për person të vetëpunësuar, (kryes të veprimtarive – noterë, përmbarues, avokatë, taksistë, zanatçinj etj.)  
(43.509 x 12 = 522.108) **522.108**

### **VLERA E PIKËS PËR PAGAT E ZYRTARËVE SHTETËRORË PËR VITIN 2022**

- Vlera e pikës për pagat e zyrtarëve shtetërorë nga data 01.01.2022 është **81,6** denarë.  
(Nga Vendimi për përcaktimin e vlerës së pikës për përllogaritje të pagave të zyrtarëve shtetërorë për vitin 2022 (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 293/21))
- Paga bazë për pagesë për persona të zgjedhur dhe të emëruar në RMV **26.755,00**  
(Nga **neni 3** nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për paga dhe kompensime të tjera të deputetëve në Parlamentin e RMV dhe personave të tjerë të zgjedhur dhe të emëruar (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 42/10) dhe ndryshimet e këtij Ligji (“Gazeta zyrtare e RMV” nr. 233/18)).

### **PAGA BAZË PËR KONTRIBUTE PËR PERSONA TË VETËPUNËSUAR NË VITIN 2022.**

(Neni 14 dhe neni 15 nga Ligji për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social)

- Persona të vetëpunësuar – kryes të veprimtarisë së pavarur ekonomike (taksisë, zanatçinj) \_\_\_\_\_ **21.755,00**
- Persona të vetëpunësuar – kryes të veprimtarive profesionale dhe veprimtarive të tjera intelektuale (avokatë, noterë, përmbarues) **43.509,00**
- Persona të vetëpunësuar – kryes të veprimtarisë profesionale dhe veprimtarisë tjetër intelektuale (avokatë, noterë etj.) deri në përfundimin e vitit të parë të fillimit të veprimtarisë \_\_\_\_\_ **21.755,00**
- Akontacioni mujor i të ardhurave neto, respektivisht të ardhurat neto të përcaktuara në mënyrë paushall në të cilën paguhet tatimi mbi të ardhurat personale (AOP 28 nga “DLD-DB“/12)

**KONTRIBUTE DHE KOMPENSIM PËR VULLNETARË DHE PERSONA TË PAPUNËSUAR**

Pagesa e kompensimit dhe kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social për vullnetarë janë të rregulluara me :

Ligjin për kontribute nga sigurimi i detyrueshëm social (“Gazeta zyrtare e RMV“ nr.142/08...247/18)

Ligjin për punësim dhe sigurim në rast të papunësisë (“Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 37/97...113/18) dhe

Ligji për vullnetarizëm (“Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 85/07... 147/15).

Kompensimi i shpenzimeve për ushqim dhe për transport tek nga vendi i vullnetarizmit paguhet jo më shumë se lartësia e 15% pagës mesatare mujore (bruto) në RMV i paguar për vitin paraprak 2021, dhe shpenzimet për udhëtime zyrtare dhe shpenzimet për trajnim paguhet në të njëjtën lartësi si për të punësuarit tek organizatori i punës vullnetare. Kompensimi për ushqim dhe transport për vullnetarë për muajin **korrik** të vitit 2022 është **6.433,00** ( $42.887 \times 15\% = 6.433,00$ ). Në këtë lartësi kompensimi është i liruar nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe është i njohur në mënyrë tatimore si shpenzim në bilancin tatimor “DB“.

Për vullnetarin paguhet edhe kontribut për invaliditet dhe dëmtim trupor të shkaktuar me lëndim, prej 4% të pagës bazë (**21.755,00**) në shumën prej **870,00** denarë.

Në LLMPI në fushën 1.3 (lloj obligimi) plotësohet shifra 222, dhe në fushën 1.4 (lloj tatimpaguesi) plotësohet shifra 110 – tatimpagues person juridik. Gjatë pagesës së kontributit për persona të papunësuar janë angazhuar për kryerjen e punëve publike në LLMPI në fushën 1.3. (lloj obligimi) vendoset shifra 242, dhe në fushën 1.4. (lloj tatimpaguesi) vendoset shifra 150. Përveç LLMPI, dorëzohet edhe:

a) buxhetet, përdoruesit buxhetorë dhe komnat në **Thesarin e Ministrisë së financave** formulari 70

b) institucionet publike shëndetësore në **Thesarin e FSSH** formulari 76.

Kontributi prej 870,00 denarë. Paguhet në këtë llogari page:

843-00149- Kontribut nga paga për SPI për të punësuarit tek persona juridik-  
Konto e të ardhurave 712113- nën programi 00

Për kompensimin për vullnetarë dhe për personat të papunësuar dorëzohet:

a) buxhetet, përdoruesit e buxheteve dhe komnat në **Thesarin e MF** formulari 60 ose kërkesa përmbledhëse 62

b) ISHP për **Thesarin e FSSH** formulari 90 ose kërkesa përmbledhëse 92.

**SHUMA MË E LARTË E KOMPENSIMIT PËR PUSHIM MJEKËSOR QË E PAGUAN FSSH**

- Kompensimi më i lartë për pushim mjekësor në barë të FSSH në **korrik** të vitit 2022

është 4 paga mesatare mujore neto të paguara në RMV në vitin 2021 (neni 17 nga LSSH) (28.718,00 x 4 = 114.872,00) \_ **114.872,00**

### **Paga bazë më e lartë**

- Për LLMPI llogaritjet duke filluar nga muaji janar i vitit 2018, paga bazë më e lartë për llogaritje të kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social është:
  - Shuma prej **16 paga mesatare** për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve për të ardhurat nga marrëdhënia e punës dhe të anëtarit ekzekutiv të bordit të drejtorëve në shoqërinë tregtare, anëtar i bordit drejtues në shoqërinë tregtare, respektivisht administrator në shoqërinë tregtare.
  - Shuma prej **12 paga mesatare** për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve për person të vetëpunësuar.
- Për LLMPI llogaritjet duke filluar për muajin **gusht të vitit 2015 deri në muajin dhjetor të vitit 2017.**, paga bazë më e lartë për llogaritje të kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social është:
  - Shuma prej **12 paga mesatare** për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve për të ardhurat nga marrëdhënia e punës dhe të anëtarit ekzekutiv të bordit të drejtorëve në shoqërinë tregtare, anëtar i bordit drejtues në shoqërinë tregtare, respektivisht administrator në shoqërinë tregtare.
  - Shuma prej **8 paga mesatare** për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve për person të vetëpunësuar
- Për LLMPI llogaritjet duke filluar për muajin mars deri në muajin korrik të vitit 2015, paga bazë për llogaritje të kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm social është:
  - Shuma prej **12 paga mesatare** për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve për të ardhurat nga marrëdhënia e punës; dhe të ardhura në bazë të kontratës për vepër dhe/ose kontratë autori ose kontratë tjetër me të cilën është përcaktuar kompensim për punën e kryer.
  - Shuma prej **8 paga mesatare** për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve për person të vetëpunësuar.
- 
- Për LLMPI llogaritjet që kanë të bëjnë me muajin janar dhe shkurt të vitit 2015 nuk aplikohet kufiri prej gjashtë pagash mesatare si paga bazë më e lartë për llogaritjen e kontributeve, respektivisht kontributet llogariten në të gjithë shumën e pagës bazë bruto.
- Paga bazë më e lartë mujore për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve për muajin **janar të vitit 2012 deri në muajin dhjetor të vitit 2014** është shuma prej 6 pagash mesatare.

Gjatë llogaritjes së pagës bazë më të lartë mujore për vitin aktual merret parasysh paga mesatare për të punësuar në RMV, të publikuar në janar në vitin aktual sipas të dhënave të ESHS. Në shumën më të lartë se paga bazë më të lartë mujore nuk llogariten dhe nuk paguhen kontribute, por llogaritet edhe paguhet tatim mbi të ardhurat personale.

Paga bazë më e lartë mujore për llogaritjen dhe pagesën e kontributeve për vitin aktual për person përdorues të kompensimit monetar gjatë kohës së papunësisë së përkohshme është 80% e pagës mesatare për të punësuar në RMV, të publikuar në janar

**të vitit aktual sipas të dhënave nga ESHS.**

Për LLMPI llogaritjet që kanë të bëjnë me llogaritjet e dorëzuara me vonesë, korrigjime të llogaritjeve, pagesë në bazë të suksesit afarist etj. Kontributet nga sigurimi i detyrueshëm social llogariten me aplikimin e pagës më të lartë bazë për llogaritjen e kontributeve në pajtueshmëri me ligjin.

**Në rast të anulimit të kontratës së punësimit për arsye tregtare, punëdhënësi është i obliguar që punonjësit t'i paguajë pagesë për shkëputje nga pune:**

Vitet e stazhit tek punëdhënësi	Lartësia e pagesës për shkëputje nga puna
deri në 5 vjet	1 pagë neto
nga 5 – 10 vjet	2,5 paga neto
10 – 15 vjet	3,5 paga neto
15 – 20 vjet	4,5 paga neto
20 – 25 vjet	6 paga neto
mbi 25 vjet	7 paga neto

Paga bazë për llogaritje të pagesës për shkëputje nga puna është paga neto mesatare e punonjësit në 6 muajt e fundit para pushimit nga puna, por e njëjta të mos jetë më e ulët se 50% e pagës mesatare neto të paguar për punonjës në Republikë në muajin e fundit para pushimit nga puna.

Pagesë për shkëputje nga puna (1)	Paga mesatare neto për punonjës në muajin paraprak (2)	Shuma më e ulët e pagesës për shkëputje nga puna (50% e shumës në kolonën 2) (3)
janar	Paga neto në m. 12/2021 ( $29.145,00 * 50\% = 14.573,00$ )	14.573,00



shkurt	Paga neto në m. 01/2022 (29.130,00 * 50% = 14.565,00)	14.565,00
mars	Paga neto në m. 02/2022 (29.943,00 * 50% = 14.972,00)	14.972,00
prill	Paga neto në m. 03/2022 (29.980,00 * 50% = 14.990,00)	14.990,00
maj	Paga neto në m. 04/2022 (29.839,00 * 50% = 14.920,00)	14.920,00
qershor	Paga neto në m. 05/2022 (31.080,00 * 50% = 15.540,00)	15.540,00
korik	Paga neto në m. 06/2022 (31.525,00 * 50% = 15.763,00)	15.763,00
gusht	Paga neto në m.07/2022 (31.407,00 * 50% = 15.704,00 )	15.704,00

## Sektori privat

Kompensime për shpenzime për të punësuar

(Njoftimi nga ESHS. 4.1.22.66 dhe 4.1.22.67 i datës 22.07.2022)

Shpenzimi	Shuma	Nuk paguhet tatimi mbi të ardhurat personale	Paguhet tatimi mbi të ardhurat personale
<p><b>Mëditje për udhëtime zyrtare brenda vendit (neni 35 paragrafi 1 aline 1 nga KPKSP, neni 12 pika 18 i LTAP)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 8% nga paga e paguar mesatare neto në RMV për 3 muajt paraprakë (31.337 x 8%)</li> </ul>	2.507,00	2.507,00	mbi 2.507,00
<p><b>Kompensim për daljen në pension (neni. 35 paragrafi 1 aline 11 nga KPKSP , neni 12 pika 22 e LTAP)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shumë e dyfishtë nga paga mesatare mujore neto e paguar në RMV në 3 muajt e fundit (31.337 x 2)</li> </ul>	62.674,00	62.674,00	mbi 62.674,00

Botues: SHKKAMV

Adresa: rr. Kazanxhiska nr.35-3/27 Shkup Çair

e-buletin

[www.shkkamvp.mk](http://www.shkkamvp.mk); [shkkamvp@gmail.com](mailto:shkkamvp@gmail.com)

<b>Ndihmë në rastin e vdekjes</b> <b>(neni 35 paragrafi 1 aline 8 dhe 9 nga</b> <b>KPKSP, neni 12 pika 9 e LTAP)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për punonjës (shumë e trefishtë nga paga mesatare neto e paguar në RMV në 3 muajt paraprakë) (31.337 x 3)</li> </ul>	94.011,00	94.011,00	mbi 94.011,00
	<ul style="list-style-type: none"> <li>• për anëtarin e familjes (shumë e dyfishtë nga paga mesatare neto e paguar në RMV në 3 muajt paraprakë) (31.337 x 2)</li> </ul>	62.674,00	62.674,00
<b>Ndihmë gjatë rasteve të katastrofave</b> <b>natyrore (neni 35-G i KPKSP, neni 12 pika</b> <b>10 e LTAP )</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shumë e njëhershme nga paga mesatare neto e paguar në RMV në 3 muajt paraprakë</li> </ul>	31.337,00	31.337,00	mbi 31.337,00
<b>Kompensim për jetë të veçuar nga familja</b> <b>(neni 35 paragrafi 1 aline 4 nga KPKSP ,</b> <b>neni 12 pika 18 e LTAP )</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 60% nga paga e mesatare neto e paguar në RMV për 3 muajt paraprakë (31.337x 60%)</li> </ul>	18.802,00	18.802,00	mbi 18.802,00

Shpenzimi	Shuma	Nuk paqehet tatimi mbi të ardhurat personale	Paqehet tatimi mbi të ardhurat personale
<b>Çmim jubilar për minimumi 10 vjet punë</b> <b>tek i njëjti punëdhënës</b> <b>(neni 35 paragrafi 1 aline 10 nga KPKSP )</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shuma e pagës mesatare neto të paguar në RMV në 3 muajt paraprakë</li> </ul>	31.337,00		e shumës së paguar
<b>Regres për pushim vjetor</b> <b>(neni 35 paragrafi 1 aline 7 nga KPKSP</b> <b>dhe neni 9 pika 2 i LTF)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 40% e pagës mesatare neto të paguar</li> </ul>			1.393,00

<p>në RMV në 3 muajt paraprakë (31.337x 40%)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 80% e pagës mesatare bruto mujore të paguar për punonjës në RMV të publikuar në ditën e pagesës (46.972x80</li> <li>• tatimi mbi të ardhurat personale (37.578,00 x 10%)</li> <li>• neto për pagesë (37.578,00 - 3.758,00)</li> </ul>	<p>12.535,00<sup>*1</sup> (neto)</p> <p>33.820,00<sup>*2</sup></p>		<p>(12.535x11,11%)</p> <p>3.758,00</p>
<p>Kompensim për pushim mjekësor për lëndim në punë dhe sëmundje profesionale më të gjatë se 6 muaj (neni 35-6 e KPKSP)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• paga mesatare mujore neto për punonjës në RMV të paguar në 3 muajt e fundit</li> </ul>	<p>31.337,00</p>		<p>e shumës së paguar</p>
<p>Shpenzime për transport të organizuar (neni 113 paragrafi 5 nga LMP, neni 12, pika 19 e LTAP)</p>	<p>në lartësinë e shpenzimeve reale</p>	<p>në lartësinë e shpenzimeve reale</p>	<p>mbi shumën e shpenzimeve reale</p>
<p>Kompensim për ushqim të organizuar (neni 113 paragrafi 5 nga LMP, neni 12 pika 19 e LTAP)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 20% e pagës mesatare neto të paguar në vitin paraprak (28.718x 20%)</li> </ul>	<p>5.744,00</p>	<p>5.744,00</p>	<p>mbi 5.744,00</p>
<p>Kompensim për përdorimin e automjetit personal për qëllime zyrtare (neni. 35 paragrafi 1 aline 5 e KPKSP, neni 12 pika 17 e LTAP)</p>	<p>Në lartësinë prej 30% e çmimit për litër karburant që e përdor automobili për çdo km. të kaluar</p>	<p>3.500,00 muaj</p>	<p>mbi shumën prej 3.500,00</p>
<p><sup>*1</sup> (shuma minimale sipas ) <sup>*2</sup> (shuma maksimale sipas Ligjit për tatimin mbi fitimin)</p>			

Shpenzimi	Shuma	Nuk paguhet tatimi mbi të ardhurat personale	Paguhet tatimi mbi të ardhurat personale
-----------	-------	--	--

Kompensim për zhvendosje për të punësuarit për nevojat e punëdhënësit (neni 35 paragrafi 1 aline 6 e KPKSP )	në lartësinë e shpenzimeve reale		Mbi shumën e pgaur
Kompensim mujor për anëtarë të organeve drejtuese (neni. 9 paragrafi 1 pika 4 e LTAP) (50% e pagës mesatare bruto në RMV nga viti paraprak (42.887 x 50% =21.444)	19.300,00 (neto)		2.144,00 (19.300 x 11,11%)
Pagesë për shkëputje nga puna për arsye afariste (tepricë teknologjike) (neni 97 i LMP dh neni 12 pika 23 e LTAP)	Në lartësinë e pagës bazë	Në lartësinë e pagës bazë	Mbi pagën bazë

Në pajtueshmëri me **nenin 9** nga Ligji për tatimin mbi fitimin (“Gazeta zyrtare e RMV“ nr. 112/14...151/21) mëditja për udhëtime zyrtare, shtesa në terren dhe jeta e veçuar përjashtohen njëra me tjetrën.

## Sektori publik

Kompensime tek ndërmarrje me më shumë se 51% në pronësi shtetërore – Ligji për pagesën e pagave në RM (LPP) (Njoftimi i ESHS. 4.1.22.66 dhe 4.1.22.67 i datës 22.07.2022)

Shpenzimi	Shuma	Nuk paguhet tatimi mbi të ardhurat personale	Paguhet tatimi mbi të ardhurat personale
<b>Regres për pushim vjetor (neni 9 nga LPP)</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 60% nga paga mesatare neto në RMV në ditën e pagesës (31.407 x 60%)</li> <li>• 80% nga paga mesatare bruto e paguar për punonjës në RMV në ditën e pagesës (46.972 x 80%=37.578)</li> <li>• tatimi mbi të ardhurat personale (37.578,00x 10%)</li> <li>• neto për pagesë (37.578,00 -3.758,00)</li> </ul>	18.844,00*1 (neto)  33.820,00*2		2.094,00 <del>112 844</del> x11,11%)  3.758,00

Shpërblim për daljen në pension (neni 9 nga LPP) • shuma e dyfishtë e pagës mesatare neto në RMV në ditën e pagesës (31.407 x 2 = 62.814,00)	62.814,00	62.814,00	mbi 62.814,00
---	-----------	-----------	------------------

## Sektori buxhetor

kompensime të shpenzimeve për të punësuar

(Njoftim i ESHS. 4.1.22.66 dhe 4.1.22.67 i datës 22.07.2022)

Shpenzim	Shuma	Nuk paguhet tatimi mbi të ardhurat personale	Paguhet tatimi mbi të ardhurat personale
<b>Mëditje për udhëtime zyrtare në brenda vendit</b> (neni 17 nga LLB dhe neni 12 nga LTAP) • një mëditje mbi 12 orë • 1/2 mëditje nga 8 -12 orë	700 den. 350 den.	700 den. 350 den.	mbi 700 den. mbi 350 den.
<b>Kompensim për daljen në pension</b> (neni 19 nga Ligji për lëshimin e buxhetit (LLB) për vitin 2022, neni 12 pika 22 nga LTAP) • shumë e dyfishtë nga paga mesatare mujore neto në RMV të publikuar në 3 muajt e fundit (31.337 x 2 = 62.674,00)	62.674,00	62.674,00	mbi 62.674,00
<b>Ndihmë gjatë pasojave më të rënda nga katastrofat natyrore</b> • nuk është parashikuar në LLB për vitin 2022.	Nuk paguhet		
<b>Ndihmë në rastin e vdekjes</b> (neni 20 nga LLB për vitin 2022, neni 12 pika 9 nga LTAP) • për të punësuar • për anëtar të familjes	62.814,00 31.407,00	62.814,00 31.407,00	mbi 62.814,00 mbi 31.407,00

<b>Kompensim për jetë të veçuar nga familja (neni 11 nga LLB për vitin 2022, neni 12 pika 18 nga LTAP)</b> • 30% nga paga e paguar neto në RMV për 3 muajt paraprakë (31.337 x 30%) – VETËM PËR FUNKSIONARËT E PËRZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR	9.401,00	9.401,00	mbi 9.401,00
<b>Çmimi jubilar për minimumi 10 vjet punë</b> • nuk është parashikuar në LLB për vitin 2022.	i përcaktuar me rregullore tjetër		Në gjithë vlerën
<b>Regres për pushim vjetor</b> • nuk është parashikuar në LLB për vitin 2022.	i përcaktuar me rregullore tjetër		Në gjithë vlerën
<b>Kompensim për Vitin e Ri</b> • nuk është parashikuar në LLB për vitin 2022.	i përcaktuar me rregullore tjetër		Në gjithë vlerën

Shpenzim	Shuma	Nuk paguhet tatimi mbi të ardhurat personale	Paguhet tatimi mbi të ardhurat personale
Kompensim për pushim mjekësor më të gjatë se 6 muaj (neni 14 nga LLB për vitin 2022)	një pagë mesatare mujore neto në organ		Në gjithë vlerën
Kompensim të shpenzimeve për zhvendosje për nevojat e punëdhënësit ( neni 13 nga LLB për vitin 2022)	Në lartësinë e shpenzimeve të realizuara reale		Në gjithë vlerën
Kompensim për përdorimin e automjetit personal për qëllime zyrtare •nuk është parashikuar në LLB për vitin 2022.	I përcaktuar me rregullore tjetër	gjer 3.500,00 në muaj	Mbi 3.500,00 në muaj
Kompensim të shpenzimeve për ushqim dhe transport për personat vullnetarë (neni 10 nga Ligji për vullnetarizmin) • 15% e pagës mesterë mujore (bruto) në RMV të paguar në vitin (2021). (42.887 x 15% = 6.433)	6.433,00	6.433,00	mbi 6.433,00

Në pajtueshmëri me **nenin 11** të Ligjit për lëshimin e buxhetit për vitin 2022, kompensimi për jetë të veçuar është parashikuar për funksionarë të përzgjedhur dhe të emëruar nëse vendi i jetesës është më i largët se 100 km nga vendi i punës.

### Norma e shpenzimeve për jetesë – inflacion në vitin 2022

Muaji	Norma	Njoftim i ESHS	
		Numri	Data
Janar	1.5%	4.1.22.14	14.02.2022
Shkurt	1.0%	4.1.22.21	07.03.2022
Mars	1.6%	4.1.22.31	07.04.2022
Prill	2.2%	4.1.22.41	09.05.2022
Maj	2.0 %	4.1.22.52	07.06.2022
Qershor	2.8 %	4.1.22.61	07.07.2022

### Numri i mundshëm i orëve në vitin 2022

Muaji	Ditët e punës	Orët e punës
Janar	21	168
Shkurt	20	160

<b>Mars</b>	<b>23</b>	<b>184</b>
<b>Prill</b>	<b>21</b>	<b>168</b>
<b>Maj</b>	<b>22</b>	<b>176</b>
<b>Qershor</b>	<b>22</b>	<b>176</b>
<b>Korrik</b>	<b>21</b>	<b>168</b>